



KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Raporti Vjetor i Punës



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORTI VJETOR I PUNËS

PËR VITIN 2024

Prishtinë
Mars, 2025

PËRMBAJTJA

1 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	6
2 KORNIZA LIGJORE.....	8
2.1 Baza ekzistuese ligjore.....	8
2.2 Përmirësimi i bazës ligjore në periudhën raportuese	9
2.3 Vështirësitë ligjore që janë hasur në përmbushjen e misionit.....	9
3 PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT	10
3.1 Misioni/Vizioni	10
3.2 Kompetencat e Këshillit.....	10
4 FUSHËVEPRIMI I KËSHILLIT	11
4.1 Organizimi i Këshillit	11
4.2 Mandati i anëtarëve të Këshillit	11
4.2.1 Kompetencat dhe funksionalizimi	12
4.3 Sekretaria	13
4.3.1 Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm.....	13
4.3.2 Departamenti për Mbështetje Profesionale	14
4.3.3 Divizioni për Shërbime të Përgjithshme	14
4.3.4 Divizioni për Buxhet dhe Financa	14
4.4 Burimet Njerëzore.....	14
4.4.1 Numri i punëtorëve	14
4.4.2 Nevojat për staf shtesë	15
4.4.3 Trajnimet e personelit në vitin 2024	16
4.4.3.1 Nevoja për trajnime gjatë vitit 2025.....	16
4.5 Asetet	17
4.5.1 Asetet në posedim të institucionit	17
4.5.2 Planet për asete të reja.....	17
5 AKTIVITETET PËR PERIUDHËN RAPORTUESE	18
5.1 Ankesat e pranuar gjatë vitit 2024	18
5.1.1 Ankesat e pranuar gjatë vitit 2022, 2023 dhe 2024.....	19
5.1.1.1 Ankesat e pranuar sipas objektit.....	20
5.1.1.2 Ankesat sipas strukturës gjinore.....	21
5.1.1.3 Ankesat sipas strukturës etnike	21
5.1.1.4 Ankesat e pranuar sipas institucioneve.....	22
5.1.1.4.1 Ankesat e pranuar – Institucionet e Administratës Qendrore	23
5.1.1.4.2 Ankesat e pranuar - Institucionet e Administratës Lokale.....	26
5.1.1.4.3 Ankesat e pranuar-Institucionet Kushtetuese dhe Agjencitë e Pavarura	

5.1.1.4.4 Ankesat e pranuar – Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.....	29
5.1.1.5 Mënyra e vendosjes së ankesave	30
5.1.1.6 Mënyra e vendosjes së ankesave sipas objektit të ankesave	32
5.1.1.7 Vendosja e ankesave sipas institucioneve	32
5.1.1.7.1 Ankesat e vendosura – Institucionet e Administratës Qendrore	33
5.1.1.7.2 Ankesat e vendosura – Institucionet e Administratës Lokale	35
5.1.1.7.3 Ankesat e vendosura – Institucionet Kushtetuese dhe Agjencitë e Pavarura	36
5.1.1.7.4 Ankesat e vendosura – Institucionet e Sistemit të Drejtësisë	36
5.1.2 FUNKSIONI I MONITORIMIT	37
5.2 Plani vjetor i punës për vitin 2025	38
5.2.1 Bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare	38
5.3 Zbatimi i vendimeve	39
5.3.1 Zbatimi i vendimeve nga organet e punësimit	39
5.3.2 Përfaqësimi dhe vendimet e gjykatës	40
5.4 Sfidat e vitit 2024.....	42
6 VLERESIME DHE REKOMANDIME	44
6.1 ORGANIZIMI I BRENDSHËM	44
6.2 KLASIFIKIMI I VENDEVE TË PUNËS DHE PAGAT E NËPUNËSVE CIVIL	45
6.3 PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL	45
6.4 USHTRIMI I POZICIONEVE TË PUNËS ME USHTRUES DETYRE	47
6.5 PROCEDURAT DISIPLINORE	48
6.6 VLERËSIMI I REZULTATEVE NË PUNË TË NËPUNËSVE CIVIL	49
6.7 TRANSFERIMI I NËPUNËSVE CIVIL	50
6.8 DOSJET E PERSONELIT	51
6.9 PËRFAQËSIMI I PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA	52
6.10 PËRFAQËSIMI ETNIK NË SHËRBIMIN CIVIL	53
7 RAPORTI FINANCIAR	55
8 RAPORTIMI RRETH ADRESIMIT TË REKOMANDIMEVE TË ZYRES KOMBËTARE TË AUDITIMIT	69

FJALA HYRËSE

I nderuar Kryetar i Kuvendit të Kosovës,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Respektimi i të drejtave dhe parimeve që e rregullojnë shërbimin civil është obligim kushtetues e ligjor, e pastaj edhe parametër matës i funksionimit të shtetit të së drejtës. Që kjo të përmbushet, Kuvendi i Kosovës duhet të sigurohet që ta mbikëqyrë zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil përmes mandatit kushtetues dhe ligjore që ia ka dhënë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tutje referuar Këshilli).

Me qëllim që kjo mbikëqyrje e Kuvendit të Kosovës mbi Këshillin të jetë edhe më përmbajtjesore jemi fokusuar që në Raportin Vjetor 2024 të prezantojmë të gjitha informacionet e nevojshme duke përfshi edhe sfidat që besoj do t'i shërbejnë vlerësimit të drejtë dhe sa më objektivë të angazhimit të Këshillit për këtë vit raportues.

Këshilli vitin 2024 e përmbylli me numrin me të madh të lëndëve të pranura dhe të shqyrtuara që nga themelimi (në vitin 2004). Gjatë këtij viti Këshilli i ka pranuar 2,137 ankesa ku ishin të përfshirë 2,598 nëpunës civilë/kandidatë për pranim në Shërbimin Civil të Kosovës.

Përveç ankesave të këtij viti, ishin edhe 169 ankesa të bartura nga viti 2023, dhe 26 ankesa të viteve paraprake, të cilat Këshilli u obligua t'i shqyrtojë nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Kështu rrjedh se numri i përgjithshëm i ankesave për shqyrtim gjatë periudhës raportuese ishte 2,332 ankesa.

Nga numri i përgjithshëm i ankesave të pranura, Këshilli në vitin 2024 i ka shqyrtuar gjithsej 1,873 ankesa ose 5.98 % më shumë se në vitin 2023. Për rreth 250 ditë pune i bie që pesë anëtarë të Këshillit, të ndihmuar nga Bashkëpunëtorët Profesional, kanë shqyrtuar mesatarisht nga shtatë (7) lëndë për çdo ditë pune. Pa dyshim kjo është ngarkesë tej mase e lartë që meriton vlerësim e mbështetje.

Përveç trajtimit të ankesave, Këshilli i ka realizuar edhe 8 vizita monitoruese të rregullta dhe 1 vizitë monitoruese sipas kërkesës së Institucionit, nga të cilat vizita janë evidentuar shkelje dhe janë dhënë rekomandime për zyrtarët përgjegjës të institucioneve përkatëse me qëllim eliminimin e shkeljeve të konstatuara me rastin e monitorimeve dhe përkundër kësaj forme të adresimit të përgjegjësive ende lë për të dëshiruar veprimi adekuatë i zyrtarëve përgjegjës.

Këshilli me përkushtim është angazhuar që ta mbikëqyrë zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës publike, duke dëshmuar konsistencë në vendimmarrje të paanshme dhe profesionale, në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin. Në këtë mënyrë Këshilli e ka përmbushur mandatin për një shërbim civil profesional dhe të paanshëm, që e pasqyron diversitetin e popullit të Kosovës dhe e respekton parimin e barazisë gjinore.

Dua t'i falënderoj anëtarët e Këshillit për përkushtimin dhe angazhimin shembullor, duke bërë që Këshilli të vendosë për numër rekord të ankesave. Po ashtu, falënderoj bashkëpunëtorët profesional dhe nëpunësit e tjerë të Sekretarisë, të cilët kanë ofruar mbështetjen e tyre profesionale dhe administrative, që t'i realizojmë me sukses funksionet në kuadër të mandatit kushtetues dhe ligjor të Këshillit.

Të nderuar deputetë, në emër të Këshillit paraqes zotimin tim para jush për përkushtim profesional, të pakursyer, punë vetëmohuese dhe shërbim të paanshëm. Ky zotim përmbushet bindshëm me mbështetjen efektive, të cilën Këshilli e mirëpret prej jush.

Ju falënderoj paraprakisht për mirëkuptimin.

Me respekt,

Arben Mehmeti
Kryetar i Këshillit të Pavarur
Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

1 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës gjatë vitit 2024 e ka vijuar veprimtarinë në ushtrimin e funksioneve të përcaktuara me nenin 6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Këto funksione kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në të gjitha institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civilë.

Raporti pasqyron në mënyrë të përmbledhur punët dhe aktivitetet e realizuara por edhe një përshkrim të shkurtër të situatës së konstatuar së bashku me vlerësimet e rekomandimet përkatëse. Ky raport përmban, po ashtu, një përshkrim të shkurtër të kornizës ligjore; informacione për organizimin, fushëveprimin, përgjegjësitë dhe autorizimet e Këshillit.

Përshkrimi i aktiviteteve është bërë në përputhje me planin vjetor të punës, duke përfshirë këtu: pranimin dhe shqyrtimin e ankesave të nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, si dhe aktivitetet lidhur me funksionin e monitorimit të institucioneve të administratës publike për zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Në vitin 2024 janë pranuar/regjistruar 2137 ankesa, ku janë përfshirë 2,598 nëpunës civilë/kandidatë për pranim në shërbimin civil. Prej tyre 2,049 ankesa janë parashtruar individualisht nga nëpunësit civilë apo kandidatet për pranim në shërbimin civil, ndërsa 88 ankesa janë parashtruar nga grup ankuesish ku të përfshirë kanë qenë gjithsej 461 nëpunës civilë.

Më tutje, gjatë periudhës raportuese për shqyrtim kanë qenë edhe 169 ankesa të bartura nga viti 2023, si dhe 26 ankesa të viteve paraprake, për të cilat Këshilli u obligua për shqyrtim dhe vendosje nga Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Nga të cekurat me lartë rrjedh se në periudhën raportuese, për shqyrtim dhe vendosje kanë qenë gjithsej 2,332 ankesa. Prej tyre 1,873 ankesa, apo 80.32% e numrit të përgjithshëm, janë shqyrtuar dhe palët janë njoftuar për vendimet, ndërsa 459 ankesa, apo 19.68% e numrit të përgjithshëm, janë bartur për shqyrtim në vitin 2025 e të cilat deri në momentin e raportimit janë shqyrtuar dhe vendosur të gjitha.

Ashtu siç pasqyrohet me sipër, rezulton se numri i ankesave të regjistruara gjatë periudhës raportuese është në rritje krahasuar me vitin 2023, ku u regjistruan 1584 ankesa, dhe vitin 2023 ku u regjistruan 1253 ankesa, çka tregon për konsolidimin e besimit ndaj Këshillit dhe rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të nëpunësve civilë por dhe palëve të treta të interesit për të adresuar problemet që i shqetësojnë në lidhje me funksionimin dhe administrimin e shërbimit civil.

Vihet re se vendin kryesor e zënë ankesat e parashtruara ndaj procedurave të rekrutimit. Këto raste përfaqësojnë mbi 33.78% të ankesave të trajtuara dhe kanë të bëjnë me shqetësimet e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, se u janë bërë padrejtësi apo janë lejuar shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar parimet e përgjithshme të pranimin në shërbimin civil.

Po ashtu një numër mjaft i madh i ankesave janë parashtruar për kompensim material. Këto raste përfaqësojnë mbi 27.84% të ankesave të trajtuara dhe kanë të bëjnë me shqetësimin e nëpunësve civilë për diskriminim apo trajtim jo të barabartë në realizimin e të ardhurave personale.

Lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë periudhës raportuese janë realizuar tetë (8) vizita të rregullta dhe një vizita me kërkesë të Institucionit, në institucionet publike të nivelit qendror dhe lokal ku si rrjedhojë janë dhënë rekomandime të posaçme për zyrtarët përgjegjës të institucioneve përkatëse.

Ndër shkeljet me të shpeshta të evidentuara, pothuajse në të gjitha institucionet e monitoruara të administratës publike, janë çështjet që kanë të bëjnë me organizimin e brendshëm dhe klasifikimin e vendeve të punës, ushtrimin e pozicioneve të punës me ushtrues të detyrës.

Vlen të theksohet së zbatimi i vendimeve nga ushtrimi i funksionit të shqyrtimit të ankesave është në nivel të kënaqshëm, derisa mbikëqyrja dhe zbatimi i rekomandimeve nga ushtrimi i funksionit të monitorimit mbetet sfidë edhe gjatë vitit 2024.

Sa i përket përfaqësimit gjyqësor, Këshilli ka vijuar të marrë pjesë në gjykimet e zhvilluara nga Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, e thirrur si palë e paditur apo si palë e interesuar, dhe nga analizimi i fakteve rrjedh se gjatë periudhës raportuese vetëm në katër raste është vendosur për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të Këshillit, çka tregon se vendimet e Këshillit *prime face* janë vlerësuar të ligjshme dhe të drejta, dhe se vlerësimi i punës së Këshillit nga Gjykata për gjatë periudhës raportuese është në rritje.

Këshilli gjatë periudhës raportuese rendësi të veçantë i ka kushtuar vendosjes dhe avancimit të bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare. Për këtë ka vijuar realizimi i vizitave në institucione të ndryshme të administratës publike të nivelit qendror dhe lokal; dhe janë realizuar takime bashkëpunimi me përfaqësuesit e SIGMA-së, si dhe me OSBE-në.

Kam kënaqësinë të ju njoftoj se me qëllim të ushtrimit të funksioneve kushtetuese dhe ligjore në mënyrë efektive dhe efikase është kryer Ristrukturimi i Sekretariatit sipas strukturës së re organizative të Këshillit.

Buxheti aktual dhe numri i lejuar i të punësuarve mbetet sfidë kryesore në funksionalizimin e strukturës organizative dhe rrjedhimisht ushtrimin e plotë dhe efektiv të mandatit, andaj për tejkalimin e këtyre sfidave kërkohet mbështetja e Kuvendit të Kosovës.

2 KORNIZA LIGJORE

Këshilli është institucion i pavarur i themeluar me aktin më të lartë juridik të Republikës së Kosovës, përkatësisht me nenin 101.2 të Kushtetutës, ku përcaktohet se: *"Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës"*.

Këshilli ushtron funksionet dhe përgjegjësitë themelore në pajtim me:

- Kushtetutën e Republikës së Kosovës;
- Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe aktet nënligjore që burojnë nga ky ligj;
- Ligji Nr.08/L-180 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil Të Kosovës;
- Aktgjykimin në rastin KO171/18 të datës 20 maj 2019 të Gjykatës Kushtetuese.

2.1 Baza ekzistuese ligjore

Me Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.08/L-180, përcaktohen funksionet, kompetencat, organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe kriteret dhe procedurat për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit.

Bazuar në dispozitat e nenit 30 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, aktet nënligjore të miratuara, janë:

1. Rregullorja Nr. 01/2018 për punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
2. Rregullorja Nr. 01/2021 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2018 për punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
3. Rregullorja Nr. 02/2018 për procedurën e shqyrtimit dhe vendosjes së ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
4. Rregullorja Nr. 04/2018 për procedurën e monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil;
5. Rregullorja Nr. 02/2021 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 04/2018 për procedurën e monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil;
6. Rregullorja Nr. 01/2023 për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe
7. Kodi i Etikës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

2.2 Përmirësimi i bazës ligjore në periudhën raportuese

Përgjithësisht Rregullores Nr.03/2018 për rregullat dhe procedurat e mbikëqyrjes se përzgjedhjes së nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe nivelit drejtues, e cila rregullore rrjedh nga funksioni i vëzhgimit, sipas nenit 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 i Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, funksion ky i shfuqizuar me Aktgjykimin në rastin KO171/18 të datës 20 maj 2019 të Gjykatës Kushtetuese, aktet e tjera nënligjore janë të zbatueshme.

Gjatë periudhës raportuese janë analizuar aktet nënligjore ekzistuese dhe si rrjedhojë është vlerësuar nevoja e ndryshimit dhe plotësimit të disa prej tyre në disa segmente të caktuara me qëllim të harmonizimit me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Plotësimi dhe ndryshimi i akteve nënligjore edhe gjatë vitit 2024 është mbështet nga OSBE.

2.3 Vështirësitë ligjore që janë hasur në përmbushjen e misionit

Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka miratuar Ligjin Nr.08/L-180 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit NR. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi nga data 17.10.2024, ndërsa përmes të njëjtit ligj janë ndryshuar kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit, kurse numri i anëtarëve është përcaktuar të jetë pesëmbëdhjetë (15). Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 08.11.2024 ka hapur konkursin për pranimin dhe emërimin e dhjetë (10) anëtarëve të Këshillit, i cili deri në periudhën e fundit të raportimit 30.03.2025 nuk ka përfunduar.

Duke marrë parasysh dispozitat e nenit 40 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, tani ka paraqitur vështirësi ligjore ngase duke marrë parasysh numrin e përcaktuar prej 15 anëtarësh sipas Ligjit Nr.08/L-180 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit NR. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli nuk ka kuorum të mbaj mbledhje të rregullta/jashtëzakonshme sikurse përcaktohet me aktet e veçanta dhe as të nxjerrë vendime të mbledhjeve të Këshillit, pasi që po ashtu me datë 27 dhjetor 2024 njëri nga anëtarët e Këshillit, është dekretuar Prokuror i Shtetit, nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhe aktualisht kanë mbetur vetëm katër (4) anëtarë.

Në rrethanat aktuale duke përfshirë periudhën kohore nga data 17.10.2024 deri në kohën e raportimit, Këshilli ka shqyrtuar dhe vendosur lidhur me ankesat e parashtruar në procedurë, pasi që ankesat i shqyrton Kolegji prej tre (3) anëtarësh.

3 PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

3.1 Misioni/Vizioni

Misioni - të mbikëqyr respektimin e rregullave dhe parimeve që e rregullojnë shërbimin civil.

Vizioni - të garantojë mbizotërimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil përgjatë procedurës së pranimit, emërimit, lëvizjes brenda kategorisë dhe ngritjes në detyrë, transferimit, pezullimit, vlerësimit, procedurës disiplinore, zhvillimit profesional, të drejtat dhe detyrimet e nëpunësit civil, dhe përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, me qëllim që ky proces të jetë i ndershëm, objektiv, i paanshëm dhe transparent për një administratë publike (shërbim civil) të qëndrueshme, profesionale, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike.

Me qëllim të përmbushjes së misionit, synohet të realizohen këto objektiva:

- Shqyrtimi i të gjitha ankesave të nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbim civil;
- Mbikëqyrja dhe vlerësimi i respektimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil;
- Funksionalizimi i strukturës organizative;
- Përditësimi i akteve nënligjore të Këshillit;
- Avancimi i bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare;
- Forcimi i kapaciteteve profesionale të Këshillit;
- Ngritja e mëtejme e transparencës së Këshillit.

3.2 Kompetencat e Këshillit

Këshilli me qëllim të ushtrimit të funksioneve, në mbështetje të dispozitave të nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka të drejtë të:

- vizitojë çdo institucion që ka të punësuar nëpunës civilë;
- ketë qasje dhe të kontrollojë dosjet dhe çdo dokument lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil;
- intervistojë çdo nëpunës civil, i cili mund të ketë informata që kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për ushtrimin e funksioneve të Këshillit;
- kërkojë dhe marrë nga institucionet çdo informacion të nevojshëm për kryerjen e detyrave të tij;
- organizojë seanca profesionale, dhe
- nxjerrë vendime, udhëzime, qëndrime dhe rekomandime.

4 FUSHËVEPRIMI I KËSHILLIT

4.1 Organizimi i Këshillit

Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës rregullon organizimin e brendshëm dhe funksionimin e Këshillit. Si rrjedhojë struktura organizative ka qenë e përcaktuar me Rregulloren Nr. 05/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa me datë 19.12.2023 është miratuar Rregullorja Nr. 01/2023 për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Struktura organizative është si vijon:

Këshilli dhe Sekretaria

Deri me datë 17.10.2024 sa ka qenë në fuqi Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është përbërë nga 7 (shtatë) anëtarë. Anëtarët emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe përbërja e Këshillit pasqyron karakterin shumetnik dhe gjinor të Kosovës. Së paku dy (2) anëtarë emërohen nga komunitetet joshqiptare, dhe së paku dy (2) anëtarë duhet të jenë të gjinisë femërore.

Nga data 17.10.2024 ka hyrë në fuqi Ligji Nr.08/L-180 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit NR. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes të cilit Këshilli përbehet nga 15 anëtare, prej tyre 3 anëtarë emërohen nga komuniteti jo shumicë, ndërsa katër (4) duhet të jenë të gjinisë femërore.

Kryetari i Këshillit zgjidhet me shumicë të votave nga radhët e anëtarëve të Këshillit, me mandat dy (2) vjeçar, dhe me mundësi rizgjedhjeje. Kryetari i Këshillit udhëheq, përfaqëson, dhe përgjigjet për veprimtarinë e Këshillit.

Në kuadër të Këshillit funksionon sekretaria, e cila ndihmon në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të Këshillit. Sekretaria udhëhiqet nga sekretari i përgjithshëm, i cili i përgjigjet drejtpërdrejtë kryetarit të Këshillit. Sekretari i përgjithshëm dhe të gjithë nëpunësit e sekretarisë e kanë statusin e nëpunësit civil, dhe trajtohen sipas legjislacionit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës.

4.2 Mandati i anëtarëve të Këshillit

Procedura për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit fillon me shpalljen e konkursit publikë, i cili publikohet në mediumet e shkruara dhe elektronike nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.


Anëtarët e Këshillit emërohen për mandat shtatë (7) vjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes për mandat tjetër.

Në periudhën raportuese Këshilli ka pasur në përbërje vetëm me pesë (5) anëtarë, ndërsa nga periudha 27.12.2024 ka pasur në përbërje vetëm katër (4) anëtarë (pasi që njëri nga anëtarët ka dhënë dorëheqje), prej tyre dy (2) anëtare të gjinisë femërore, ndërsa numri i anëtarëve të komunitetit joshqiptar ende nuk është plotësuar sikurse as numri i mbetur i lirë prej njëmbëdhjetë (11) anëtarësh deri në kohën e raportimit edhe përkundër përpjekjeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Anëtarët aktualë janë zgjedhur më 08.10.2020, dhe të njëjtit kanë mandat deri më datë 08.10.2027. Anëtari i Këshillit nuk ka të drejtë që gjatë mandatit të tij të ushtrojë ndonjë funksion tjetër shtetëror, të jetë anëtar i partisë politike apo të marrë pjesë në aktivitete politike.

Kryetari dhe anëtarët e Këshillit lidhur me vendimmarrjen në kuadër të funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit, gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi.

ORGANOGRAMI I KËSHILLIT



4.2.1 Kompetencat dhe funksionalizimi

Këshilli në ushtrimin e funksioneve të përcaktuara ligjore ka të drejtë të:

- Nxjerr vendime, udhëzime, qëndrime dhe rekomandime;
- Organizojë seanca profesionale.

Në periudhën raportuese janë mbajtur nëntë 8 mbledhje të Këshillit, ku janë nxjerr 16 vendime. Vendimet e nxjerra kanë të bëjnë me miratimin e Planit të Punës për vitin 2024, Planit Vjetor të Monitorimit për vitin 2024, Raportin Vjetor të Punës për vitin 2023; Raporteve të Rregullta të Monitorimit për Institucionet e Administratës Publike, formimin e Kolegjeve për shqyrtim të ankesave dhe të tjera çështje operative.

4.3 Sekretaria

Në kuadër të Këshillit funksionon sekretaria, e cila ndihmon në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të Këshillit. Sekretaria udhëhiqet nga sekretari i përgjithshëm, i cili i përgjigjet drejtpërdrejtë kryetarit të Këshillit.

Struktura organizative e sekretarisë përbëhet nga:

- 1.1. Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm;
- 1.2. Departamenti për Mbështetje Profesionale;
 - 1.2.1. Divizioni për Shqyrtimin e Ankesave;
 - 1.2.2. Divizioni i Monitorimit dhe Mbikëqyrjes;
- 1.3. Divizioni për Shërbime të Përgjithshme;
- 1.4. Divizioni për Buxhet dhe Financa.

4.3.1 Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit përbëhet nga:

- 1.1 Sekretari i Përgjithshëm;
- 1.2 Stafi profesional; dhe
- 1.3 Personeli mbështetës.

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit është nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese, mandati i të cilit është i njëjtë me mandatin e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues, siç përcaktohet me ligjin përkatës për zyrtarët publikë. Sekretari i Përgjithshëm është zgjedhur më 15.08.2022 dhe të njëjtit i përfundon mandati i rregullt më 15.08.2026.

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për drejtimin, koordinimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e sistemit të brendshëm administrativ, përfshirë administrimin e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore.

Sekretari i Përgjithshëm i përgjigjet drejtpërdrejt Kryetarit të Këshillit.

Nëpunësit civil profesional dhe mbështetës në kuadër të Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm janë:

- 1.1 Zyrtari i lartë për burime njerëzore;
- 1.2 Zyrtari i lartë i prokurimit;
- 1.3 Zyrtari certifikues;
- 1.4 Zyrtar i lartë për Komunikim me Publikun;

4.3.2 Departamenti për Mbështetje Profesionale

Departamentit për Mbështetje Profesionale përbëhet nga stafi profesional dhe ka për mision të mbështesin në mënyrë të drejtpërdrejtë punën profesionale të anëtarëve të Këshillit në ushtrimin e funksioneve themelore të përcaktuara me ligjin përkatës për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Ky departament përbëhet nga dy divizione.

Divizionet mbështesin anëtarët e Këshillit në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizimin e funksioneve për shqyrtimin e ankesave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, si dhe përfaqëson Këshillin në kontestet gjyqësore në gjykatë.

Po ashtu këto divizione bëjnë përgatitjet e duhura për mbarëvajtjen e seancave dëgjimore, publike dhe jopublike, si dhe mban procesverbalin e seancave. Nën drejtimin e anëtarëve të Këshillit përgatisin propozim-vendimet dhe propozim-raportet për realizimin e funksioneve ligjore të Këshillit.

4.3.3 Divizioni për Shërbime të Përgjithshme

Divizioni për Shërbime të Përgjithshme është njësi administrative e cila ka për mision planifikimin, koordinimin dhe ofrimin e shërbimeve administrative, logjistike dhe të teknologjisë informative për të gjitha organet dhe njësit administrative në kuadër të Këshillit.

4.3.4 Divizioni për Buxhet dhe Financa

Divizioni për Buxhet dhe Financa është njësi administrative e cila ka për mision planifikimin, zbatimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar.

4.4 Burimet Njerëzore

4.4.1 Numri i punëtoreve

Sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2024, numri i përgjithshëm i pozitave të miratuara është gjithsej tridhjetë (30), prej të cilëve shtatë (7) zyrtarë publikë të zgjedhur, njëzetënjë (21) nëpunës civilë të karrierës dhe dy (2) nëpunës administrativ.

Tabela 1. Burimet njerëzore

Këshilli	Numri i punonjësve në Ligjin e Buxhetit	Numri aktual i punonjësve në fillim të 2024	Numri aktual i punonjësve në fund të vitit 2024
Funksionarë publikë të zgjedhur	7	5	4
Administratë (staf civil)	21	20	20
Nëpunës teknik dhe Mbështetës	2	2	2
Total	30	27	26

Tabela 2. Struktura gjinore

Statusi	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Funksionarë publikë të zgjedhur	2	2	4
Administratë (staf civil)	12	8	20
Nëpunës teknik dhe Mbështetës	1	1	2
Total	16	11	26

Gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar gjashtë (6) procedura dhe rrjedhimisht kanë përfunduar me sukses pesë procedura të rekrutimit, ndërsa një procedura ka dështuar për arsye së nuk ka pasur kandidat të Suksesshëm në fazën e testimit:

- Një pozitë Drejtor Departamenti për Mbështetje Profesionale
- Një pozitë Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtim të Ankesave
- Dy pozita Zyrtar i Lartë për Inspektim Administrativ
- Një pozitë Zyrtar për Shpenzime, Pasuri dhe Asete (e dështuar)
- Një pozitë e nëpunës teknik dhe mbështetës

Një nëpunës është transferuar në Komunën e Vushtrri dhe një pozitë Zyrtare e Larte për Komunikim me Publikun është bërë transferim nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike.

Po ashtu vlen të theksohet së gjatë kësaj periudhe një nëpunës civil ka arritur moshën e pensionimit dhe për rrjedhojë ka përfunduar marrëdhënien e punës.

Niveli i pagës së kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit si dhe zyrtarëve publik në kuadër të Këshillit është i përcaktuar me Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

4.4.2 Nevojat për staf shtesë

Në periudhën raportuese një ndër sfidat kryesore për ushtrimin e funksioneve të përcaktuara ligjore ishte mungesa e burimeve të mjaftueshme njerëzore.

Numri i ankesave të parashtruara nga nëpunësit civilë dhe kandidatet për pranim në shërbimin civil në periudhën raportuese është rritur dukshëm në krahasim me vitin paraprak. Ndërkaq edhe kërkesat për monitorim të jashtëzakonshëm janë shtuar. Për pasojë një gjë e tillë ka ndikuar në rritjen e kërkesës për rekrutimin të punëtorëve të rinj, me qëllim të ushtrimit të mandatit kushtetues dhe ligjor në mënyrë efektive dhe efikase.

Mungesa e buxhetit për rekrutimin e punëtorëve të rinj e ka vështirësuar ushtrimin e funksionit të shqyrtimit të ankesave në kuptim të trajtimit të tyre në afatin ligjor prej 45 ditësh, siç përcaktohet me nenin 17 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Kjo për faktin se gjatë kësaj periudhe kishim për shqyrtim gjithsej 2,332 ankesa, numër ky mjaft i lartë në raport me kapacitetet në dispozicion për shqyrtimin e tyre.

Po ashtu, mungesa e buxhetit për rekrutimin e stafit profesional, ka ndikuar që plani vjetor i monitorimit të mos përfshijë edhe një numër të madh të institucioneve për monitorim të rregullt, ashtu sikurse edhe refuzimin e një numri të caktuar të kërkesave për monitorim të

jashtëzakonshëm, funksion ky që rrjedh nga neni 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe neni 20 i Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Siç jeni në dijeni me miratimin e ligjit nr.08/L-180 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i cili ka hyrë në fuqi nga data 17 tetor 2024, janë paraqitur rrethana të reja dhe rrjedhimisht edhe kërkesa shtesë buxhetore, për faktin se me këtë ligj është rritur numri i anëtarëve, nga shtatë (7), në pesëmbëdhjetë (15).

Andaj në vlerësimin tonë është më se e nevojshme që të kemi buxhetin e ndarë dhe rrjedhimisht planifikimin e pagave për tetëmbëdhjetë (18) zyrtar të cilët do të ndihmojnë anëtarët e Këshillit për shqyrtimin e ankesave, monitorimin e institucioneve publike si dhe zyrtarë të tjerë administrative dhe financiar të paraparë sipas **Rregullores nr.01/2023** për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është miratuar në mbledhjen e mbajtur me datë 19.12.2023 me Vendimin VM/2023 me nr.7565/2023.

4.4.3 Trajnimet e personelit në vitin 2024

Gjatë vitit 2024, zyrtarët e Sekretariatit të Këshillit kanë vijuar trajnimet e organizuara nga:

- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit dhe mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, me temën Sinjalizimi: një instrument esencial në luftën kundër korrupsionit.
- Agjencinë për Informim dhe Privatësi me temën Bazat e Mbrojtjes së të Dhënave Personale.
- Misioni i OSBE-së në fushën e teknologjisë informative lidhur me trajnimin MS WORD, MS EXCEL, PowerPoint, Google dhe ChatGPT, MS Word, MS Excel, MS Power Point dhe Sisteme dhe komunikim (IT essentials, Gmail, Gdrive, Chatgpt).

Ndërsa trajnimet e tjera të planifikuara nuk janë realizuar si pasojë e mungesës së buxhetit në kategorinë përkatëse.

4.4.3.1 Nevoja për trajnime gjatë vitit 2025

Ngritja e kapaciteteve profesionale e zyrtarëve që kryejnë detyra specifike është bazë për funksionimin e duhur dhe të mirëfilltë dhe rrjedhimisht arritjen e objektivave institucionale.

Këshilli për ngritjen e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve mbështetës ka planifikuar këto trajnime dhe aktivitete:

- Trajnime profesionale në fushën e legjislacionit për shërbimin civil dhe ligjit për procedurën e përgjithshme administrative;
- Trajnime për administrimin dhe përditësimin e bazës së të dhënave; dhe
- Organizimin e vizitave studimore në institucione homologe.

Vlerësohet si i domosdoshëm trajnimi i vazhdueshëm në fushat specifike, mirëpo mungesa e buxhetit në kategorinë përkatëse mbetet sfidë e vazhdueshme edhe gjatë vitit 2025.

4.5 Asetet

4.5.1 Asetet në posedim të institucionit

Këshilli si pasuri jo financiare, për nevoja pune, posedon mobilie (tavolina, karrige, sirtarë, sirtarë për arkiv), vetura dhe pajisje të tjera të teknologjisë informative.

Pasuria është e ndarë në dy përmbledhje:

1. Pasuri jokapitale, me vlerë nën €1,000.00, në posedim të organizatës buxhetore janë mobiliat dhe pajisjet e teknologjisë informative të përdorshme, ku vlera e tanishme e pasurisë pas amortizimit ndër vite është €11,618.50.
2. Pasuri kapitale me vlerë mbi €1,000.00 në posedim të organizatës buxhetore janë veturat dhe pajisjet e teknologjisë informative, shumica e të cilave janë jashtë përdorimit dhe vlera e tanishme e pasurisë kapitale pas amortizimit ndër vite është € 00.00.

Vlerat e lartcekura janë prerje në fund të vitit kalendarik dhe financiar të vitit 2024. Raportimi i detajuar për pasuritë e lartcekura është në Raporti Vjetor Financiar 2024, sikurse përcaktohet me nenin 19 - Raporti për pasurinë jo financiare.

4.5.2 Planet për asete të reja

Këshilli është i vendosur në objekt shtetëror me adresë të institucionit – *Objekti Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Kati III, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës.*

Objekti ku është i vendosur institucioni ka mungesë të hapësirave për punë, respektivisht mungesë të zyrave dhe sallave për organizimin e mbledhjeve dhe të seancave dëgjimore, si dhe nuk ka hapësirë dhe kushte për arkivimin e lëndëve. Në mungesë të hapësirave të nevojshme për punë të cilat nuk i plotësojnë kushtet elementare për punë në kuptim të standardëve të përcaktuara me rregulla ligjore në fuqi.

Rrjedhimisht, selia e institucionit është planifikuar të bartet në objektin e ish-Ndërtesës së Rilindjes. Me rastin e zhvendosjes në lokacionin e ri nevojiten mobilie dhe pajisje për punë, të cilat do të planifikohen në koordinim me njësinë përkatëse në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

5 AKTIVITETET PËR PERIUDHËN RAPORTUESE

Në vijim të këtij raporti janë të përshkruara aktivitetet e realizuara në kuadër të ushtrimit të funksionit të shqyrtimit të ankesave, duke krahasuar me të dhënat mbi aktivitetet e tri vjetëve të fundit, si dhe aktivitetet në ushtrimin e funksionit të monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Po ashtu kjo pjesë e raportit përmban një përshkrim të shkurtër mbi planin vjetor të punës të vitit raportues dhe vitit aktual, zbatimin e vendimeve nga institucionet e administratës publike, bashkëpunimin vendor dhe ndërkombëtar, përfaqësimin gjyqësor, si dhe sfidat e paraqitura gjatë periudhës raportuese.

5.1 Ankesat e pranuar gjatë vitit 2024

Këshilli e ka përmbyllur vitin 2024 me numrin me të madh të lëndëve të pranuar dhe rrjedhimisht të shqyrtuara që nga themelimi i tij.


Në vitin 2024 janë pranuar/regjistruar 2137 ankesa, ku janë përfshirë 2,598 nëpunës civilë/kandidatë për pranim në shërbimin civil. Prej tyre 2,049 ankesa janë parashtruar individualisht nga nëpunësit civilë apo kandidatet për pranim në shërbimin civil, ndërsa 88 ankesa janë parashtruar nga grup ankuesish ku të përfshirë kanë qenë gjithsej 461 nëpunës civilë.

Këshilli, përveç ankesave të pranuar gjatë periudhës raportuese (numri i të cilave ishte 2137) ka pasur për shqyrtim edhe 169 ankesa të bartura nga viti 2023, si dhe 26 ankesa të viteve paraprake, të cilat janë shqyrtuar si rezultat i shterimit të mjeteve juridike në konflikt administrativ dhe detyrimit nga Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Tabela 3. Ankesat e pranuar/shqyrtuara

Ankesa	Të pranuar 2024	Të bartura nga viti 2023	Detyrim sipas Gjykatës	Numri i përgjithshëm	Në përqindje
Të pranuar	2,137	169	26	2,332	100%
Të shqyrtuara	1,688	162	23	1,873	80.32%
Në proces të shqyrtimit	449	7	3	459	19.68%

Diagrami 1. Paraqitja grafike e të dhënave sipas tabelës nr.3



Nga të cekurat me lartë rrjedh se në vitin 2024 kanë qenë për shqyrtim gjithsej 2,332 ankesa, ku prej tyre 1,873 ankesa apo 80.32% e ankesave, janë shqyrtuar dhe palët janë njoftuar lidhur me vendimmarrje. Ndërsa 459 ankesa, apo 19.68% e ankesave, janë bartur për shqyrtim në vitin 2025 të cilat deri në momentin e raportimit janë shqyrtuar dhe vendosur të gjitha.

5.1.1 Ankesat e pranuar gjatë vitit 2022, 2023 dhe 2024

Nga analizimi i të dhënave të mbledhura ndërlidhur me ushtrimin e funksionit të shqyrtimit dhe vendosjes së ankesave vërehet rritje e numrit të ankesave të pranuar gjatë periudhës raportuese në krahasim me dy vitet paraprake, të cilat të dhëna pasqyrohen si në vijim:


- Në vitin 2022 janë pranuar/regjistruar 1,253 ankesa;
- Në vitin 2023 janë pranuar/regjistruar 1,584 ankesa.
- Në vitin 2024 janë pranuar/regjistruar 2,137 ankesa.

Ky trend i rritjes së numrit të ankesave ndër vite tregon për konsolidimin e besimit ndaj punës së Këshillit si dhe rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të nëpunësve civilë dhe palëve të interesit për të adresuar problemet që i shqetësojnë në lidhje me funksionimin dhe administrimin e shërbimit civil.

Tabela 4. Ankesat e pranuar gjatë viteve 2022, 2023 DHE 2024

Viti	Ankesa të pranuar	Detyrim sipas Gjykatës	Numri i përgjithshëm	Rritja në (%) nga viti në vit
2022	1,253	198	1,451	100%
2023	1,584	49	1633	12.54%
2024	2,137	26	2,163	32.46%

Diagrami 2. Paraqitja grafike e të dhënave sipas tabelës nr.4



Ky raport po ashtu pasqyron në mënyrë të detajuar të dhënat statistikore për ankesat e pranuar dhe rrjedhimisht të shqyrtuara, sipas:

- objektit të ankesës;
- strukturës gjinore dhe etnike të ankuesve;
- institucioneve ndaj të cilave është paraqitur ankesë;
- objektit të ankesës për secilin institucion; dhe
- mënyrës së vendosjes së ankesave.


5.1.1.1 Ankesat e pranuar sipas objektit

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka pranuar ankesa me objekt të ndryshëm të ankimi dhe të njëjtat janë regjistruar sipas llojit të objektit, të cilat janë të pasqyruar në tabelën si në vijim:

Tabela 5. Ankesat e pranuar sipas objektit gjatë vitit 2024

Nr.	Objekti i ankesave	Numri i ankesave	Përqindja
1	Kontestim konkursi	722	33.78%
2	Kompensim material	595	27.84%
3	Kërkesa nga marrëdhënia e punës	237	11.09%
4	Shkelje e të drejtës në pagë	214	10.01%
5	Masë disiplinore	177	8.27%
6	Transferim	87	4.06%
7	Vlerësim i rezultateve në punë	47	2.18%
8	Ndërprerje e marrëdhënies së punës	26	1.21%
9	Pezullimi i marrëdhënies së punës	24	1.12%
10	Pezullim parandalues	8	0.37%
11	Gjithsej	2137	100%

Diagrami 3. Paraqitja grafike e të dhënave si në tabelën nr.5



Nga të dhënat e pasqyruara si më lart vihet re se vendin kryesor e zënë ankesat e parashtruara për Kontestim konkursi. Këto raste përfaqësojnë mbi 33.78% të ankesave të pranuar.

Po ashtu një numër mjaft i madh i ankesave janë parashtruar për kompensim material. Këto raste përfaqësojnë mbi 27.84% e ankesave të pranuar.


5.1.1.2 Ankesat sipas strukturës gjinore

Nga numri i përgjithshëm i ankesave të pranura gjatë periudhës raportuese, struktura gjinore është e pasqyruar në tabelën si në vijim:

Tabela 6. Ankesat sipas strukturës gjinore

Nr.	Ankesat sipas strukturës gjinore	Numri i ankesave	Përqindja
1	Meshkuj	1303	60.98%
2	Femra	834	39.02%
3	Gjithsej	2137	100%

Diagrami 4. Paraqitja grafike e të dhënave si në tabelën nr.6




5.1.1.3 Ankesat sipas strukturës etnike

Nga numri i përgjithshëm i ankesave të pranura gjatë periudhës raportuese, struktura etnike është e pasqyruar në tabelën si në vijim:

Tabela 7. Ankesat sipas strukturës etnike

Nr.	Ankesat sipas strukturës etnike	Numri i ankesave	Përqindja
1	Shqiptar	2077	97.19%
2	Serb	49	2.30%
3	Boshnjak	8	0.38%
4	Turk	2	0.09%
5	Egjiptian	1	0.04%
	Gjithsej	2137	100%

Diagrami 5. Paraqitja grafike e të dhënave si në tabelën nr.7




5.1.1.4 Ankesat e pranuar sipas institucioneve

Nga numri i përgjithshëm i ankesave të pranuar gjatë periudhës raportuese, ankesat e pranuar sipas institucioneve janë të pasqyruara në tabelën si në vijim:

Tabela 8. Ankesat e pranuar sipas institucioneve

Nr.	Institucionet	Numri i ankesave	Përqindja
1	Institucionet e administratës qendrore	1379	64.39%
2	Institucionet e administratës lokale	568	26.47%
3	Institucione kushtetuese dhe agjencitë e pavarura	104	4.84%
4	Institucionet e sistemit të drejtësisë	86	4.03%
5	Gjithsej	2,137	100%

Diagrami 6. Paraqitja grafike e të dhënave si në tabelën nr.8



5.1.1.4.1 Ankesat e pranuar – Institucionet e Administratës Qendrore

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka pranuar për shqyrtim 1379 ankesa, apo 64.39% e numrit të përgjithshëm të ankesave, të parashtruara ndaj institucioneve të administratës qendrore dhe të njëjtat janë ndarë sipas objektit, sikur pasqyrohen në vijim:

Tabela 9. Ankesat e pranuar ndaj institucioneve të administratës qendrore

Institucionet e Administratës Qendrore	Kërkesa nga m. e punës	Kompensim material	Kontestim konkursi	Masë disiplinore	Ndërprerje e m. punës	Shkelje e të drejtës në pagë	Pezullim parandalues	Pezullim nga mardhëna e punës	Transferime	Vlerësim i punës	Gjithsej	Përqindja
Ministria e Mbrojtjes	16	237	11								264	12.36%
Ministria e Punëve të Brendshme	18	20	49	5		30	1	4	11	3	141	6.60%
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	6	24	40	3	2	4			22		101	4.73%
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit	5	4	86	1					2		98	4.59%
Shërbimi Korrektues i Kosovës	10	39	13	18	2	1					83	3.89%
Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	7	7	31	10	3				4		62	2.90%
Zyra e Kryeministrit	33	4	20						1		58	2.71%
Ministria e Shëndetësisë	5	16	5	12	2	9			3	1	53	2.48%
Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	3	7	17	11		2	1			5	46	2.15%
Inspektorati i Punës			32	2	1			1	3	5	44	2.05%
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	8	3	13	5	3				2	2	36	1.68%
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	4	1	8	20						1	34	1.59%
Administrata Tatimore e Kosovës	7		1	2	1			11	5	1	28	1.31%
Ministria e Drejtësisë		11	7	3					5	1	27	1.27%



Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë	3	2	20			2					27	1.27%
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	1	2	12	9		1				1	26	1.21%
Agjencia e Punësimit	1		24							1	26	1.21%
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës	1	5	15			2				1	24	1.12%
Agjencia e Statistikave të Kosovës	2	3	4	2		8			1	1	21	0.98%
Agjencia e Shoqërisë së Informacionit	16										16	0.74%
Agjencia Pyjore e Kosovës	3		5	2		1				1	12	0.56%
Shërbimi Sprovues i Kosovës		2	10								12	0.56%
Kuvendi i Republikës së Kosovës	2	5		2		1				1	11	0.51%
Agjencia e Menaxhimit Emergjent	6		4			1					11	0.51%
Agjencia e Kosovës për Pajisje dhe Produkte Medicinale	1	3	3			2					9	0.42%
Ministria e Ekonomisë	1	1	4	3							9	0.42%
Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor	1	2	2			1				2	8	0.38%
Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës			7		1						8	0.38%
Ministria e Zhvillimit Rajonal		4	2						1		7	0.33%
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal		1	5								6	0.28%
Autoriteti i Aviacionit Civil	1	2	2	1							6	0.28%
Policia e Kosovës	3	2				1					6	0.28%
Agjencia për ndihmë juridike Falas			5						1		6	0.28%
Instituti i Kosovës për administratë publike	1		1						1	2	5	0.23%
Qendra e Studentëve	1		4								5	0.23%
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	1	1	3								5	0.23%
Këshilli i Sigurisë së Kosovës		1		2		1					4	0.18%
Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit		3									3	0.14%
Agjencia e Kosovës për Forenzikë		2								1	3	0.14%
Universiteti i Prishtinës		2		1							3	0.14%
Ministria për Komunitete dhe Kthim		1	2								3	0.14%
Dogana e Kosovës	2										2	0.09%
Agjencia e Kosovës për sekuestrimin e pasurisë së sekuestruar			2								2	0.09%
Instituti Kombëtar i shëndetësisë publike		2									2	0.09%
Zyra e Rregullatorit për Energji	1		1								2	0.09%
Autoriteti Kombëtar i kualifikimeve										2	2	0.09%



Inspektorati i Policisë së Kosovës			1								1	0.04%
Presidenca e Kosovës		1									1	0.04%
Akademia e Kosovës për Siguri Publike		1									1	0.04%
Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale				1							1	0.04%
Universiteti i Mitrovicës		1									1	0.04%
Agjencia e Akreditimit të Kosovës			1								1	0.04%
Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës						1					1	0.04%
Autoriteti Rregullator i Hekurudhave						1					1	0.04%
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Ferizaj		1									1	0.04%
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Malishevë		1									1	0.04%
Biblioteka Kombëtare e Kosovës						1					1	0.04%
Muzeu i Kosovës						1					1	0.04%
Gjithsej	170	424	472	115	15	71	2	16	62	32	1379	64.39%



5.1.1.4.2 Ankesat e pranuar - Institucionet e Administratës Lokale

Gjatë periudhës raportuese janë pranuar për shqyrtim 568 ankesa, apo 26.47 % e numrit të përgjithshëm të ankesave, të parashtruara ndaj institucioneve të administratës lokale dhe të njëjtat janë ndarë sipas objektit, që pasqyrohen si në vijim:

Tabela 10. Ankesat e pranuar ndaj institucioneve të administratës lokale sipas objektit të ankesave

Institucionet e Administratës Lokale	Kërkesa nga m. e punës	Kompensim material	Kontestim konkursi	Masë disiplinore	Ndërprerje e m. punës	Shkelje e të drejtës në pagë	Transferim	Vlerësim i punës	Pezullim nga Marrëdhënia e Punës	Pezullim parandalues	Gjithsej	Përqindja
Komuna e Prishtinës	9	48	31	4		9	2	1			104	4.87%
Komuna e Suharekës	1	48	2			3					54	2.53%
Komuna e Gjilanit	11	11	10	5		5	1	2			45	2.11%
Komuna e Kamenicës	3	5	5	7	2	9		3		1	35	1.64%
Komuna e Mitrovicës së Jugut	1		14		1	8	5				29	1.36%
Komuna e Lipjanit	2		2	1		23					28	1.31%
Komuna e Prizrenit		2	16	2		4					24	1.12%
Komuna e Klinës	5	1	6			2	7		1		22	1.03%
Komuna e Obiliqit	2	2	4			10		1	1		20	0.94%
Komuna e Pejës	1	1	3	1		5	1	3	1	3	19	0.89%
Komuna e Shtimes	5	1	7	2		4					19	0.89%
Komuna e Fushë Kosovës	4	1	1			12					18	0.84%
Komuna e Ferizajt	2	4	2			4	2		1		15	0.70%
Komuna e Vitisë			10		2	1					13	0.60%
Komuna e Mitrovicës Veriore			12								12	0.56%



Komuna e Dragashit	2		8								10	0.47%
Komuna e Istogut		2	3					1	3	1	10	0.47%
Komuna e Kaçanikut	1		2			5					8	0.37%
Komuna e Kaçanikut	1		2			5					8	0.37%
Komuna e Vushtrrisë		1	5	1		1					8	0.37%
Komuna e Ranillikut			1		1	5	1				8	0.37%
Komuna e Rahovecit	2	3	2								7	0.32%
Komuna Skenderajt		1	2	1		3					7	0.32%
Komuna e Podujevës			4	1		1	1				7	0.32%
Komuna e Hanit të Elezit		2		2		2		1			7	0.32%
Komuna e Shtërpçës			1			6					7	0.32%
Komuna e Gjakovës			1	2				1			4	0.18%
Komuna e Klllokotit			2	1						1	4	0.18%
Komuna e Junikut			4								4	0.18%
Komuna e Zveqanit			2	1							3	0.14%
Komuna e Leposaviqit			1		1						2	0.09%
Komuna e Malishevës						2					2	0.09%
Komuna e Deçanit			1								1	0.04%
Komuna e Graçanicës						1					1	0.04%
Komuna e Mamushës			1								1	0.04%
Komuna e Parteshit		1									1	0.04%
Komuna e Novobërdës			1								1	0.04%
Gjithsej	52	134	168	31	7	130	20	13	7	6	568	26.47%



5.1.1.4.3 Ankesat e pranuara-Institucionet Kushtetuese dhe Agjencitë e Pavarura

Gjatë periudhës raportuese janë pranuar për shqyrtim 104 ankesa, apo 4.84 % të numrit të përgjithshëm të ankesave, të parashtruara ndaj institucioneve kushtetuese dhe agjencive të pavarura dhe të njëjtat janë ndarë sipas objektit, që pasqyrohen si në vijim:

Tabela 11. Ankesat e pranuara ndaj institucioneve kushtetuese dhe agjencive të pavarura sipas objektit të ankesave

Institucionet Kushtetuese dhe Agjencitë e Pavarura	Kërkesa nga m. e punës	Kompensim material	Kontestim Konkursi	Masë disiplinore	Ndërprerje e m. punës	Shkelje e të drejtës në pagë	Pezullim nga m. e punës	Transferime	Vlerësim i punës	Gjithsej	Përqindja
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	3	1	15	1				2		22	1.03%
Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror	2	6		1	2	7				18	0.84%
Agjencia Kosovare e Privatizimit		2	8	3				3	1	17	0.79%
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës	3	1	1	5					1	11	0.51%
Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit			7							7	0.33%
Agjencia për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës	2		2	2						6	0.28%
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale		1	4							5	0.24%
Agjencia për Informim dhe Privatësi			5							5	0.24%
Organi Shqyrtues i Prokurimit			2			1				3	0.14%
Komisioni i Pavarur për Media	1		2							3	0.14%
Institucioni i Avokatit të Popullit				1			1			2	0.09%
Sekretariati i KPMSHCK-së			1	1						2	0.09%
Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare				1						1	0.04%
Zyra Kombëtare e Auditimit			1							1	0.04%
Akademia e Drejtësisë		1								1	0.04%
Gjithsej	11	12	48	15	2	8	1	5	2	104	4.84%

5.1.1.4.4 Ankesat e pranuar – Institucionet e Sistemit të Drejtësisë

Gjatë periudhës raportuese janë pranuar për shqyrtim 86 ankesa, apo 4.03 % e numrit të përgjithshëm të ankesave, të parashtruara ndaj institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe të njëjtat janë ndarë sipas objektit, që pasqyrohen si në vijim:

Tabela 12. Ankesat e pranuar ndaj Institucioneve të drejtësisë sipas objektit të ankesave

Institucionet e Sistemit të Drejtësisë	Kërkesa nga m. e punës	Kompensim material	Kontestim Konkursi	Masë disiplinore	Ndërprerje e m. punës	Shkelje e të drejtës në pagë	Pezullim parandalues	Transferime	Vlerësim i punës	Gjithsej	Përqindja (%)
Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	2	22	16	5		9				54	2.53 %
Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës	3	3	15	9	1	1				32	1.50 %
Gjithsej	5	25	31	14	1	10				86	4.03 %


5.1.1.5 Mënyra e vendosjes së ankesave

Në këtë pjesë të raportit paraqiten të dhënat lidhur me mënyrën e vendosjes së ankesave duke përfshirë këtu numrin e përgjithshëm të ankesave të shqyrtuara gjatë periudhës raportuese, gjegjësisht 1,850 ankesa.

Tabela 13. Mënyra e vendosjes së ankesave

Mënyra e vendosjes	Numri i ankesave	Përqindja
Të refuzuara	532	28.77%
Të hedhura poshtë	515	27.85%
Të aprovuara	271	14.66%
Përfundim i procedimit administrativ	151	8.17%
Kthimi në rishqyrtim	111	5.95%
Të aprovuara pjesërisht	96	5.20%
Shpallja jo kompetent	86	4.65%
Detyrim për vendosje	82	4.43%
E pezulluar	6	0.32%
Gjithsej	1850	100%

Diagrami 7. Paraqitja grafike e të dhënave si në tabelën nr.13



Të refuzuara - janë vendime me të cilat është konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesve nuk janë të bazuara dhe rrjedhimisht janë lenë në fuqi aktet apo veprimet e organeve të punësimit.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka refuzuar 532 ankesa.

Të aprovuara - janë vendime me të cilat është vendosur në mënyrë meritore se pretendimet ankimore janë të bazuara dhe rrjedhimisht janë anuluar apo shfuqizuar aktet e organeve të punësimit, duke i obliguar të njëjtat për zbatimin e vendimeve të Këshillit.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka aprovuar **271** ankesa.

Të aprovuara pjesërisht - janë vendime me të cilat është vendosur se pretendimet ankimore të ankuesve janë pjesërisht të bazuara dhe rrjedhimisht janë anuluar, shfuqizuar apo ndryshuar aktet e organeve të punësimit, duke i obliguar të njëjtat për zbatimin e vendimeve të Këshillit.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka aprovuar pjesërisht **96** ankesa.

Kthim në rishqyrtim - janë vendime me të cilat janë konstatuar të metat e aktit administrativ të kontestuar apo të metat e tjera procedurale të cilat e kanë pamundësuar Këshillin që të vendos në mënyrë meritore.

Këshilli, për periudhë raportuese, ka vendosur që lënda të kthehet në rishqyrtim në **111** raste.

Detyrime për vendosje - janë vendime me të cilat është konstatuar se organi i punësimit pa të drejtë nuk ka nxjerr akt administrativ dhe rrjedhimisht palës iu kanë cenuar të drejtat nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka nxjerr **82** vendime, me të cilat janë detyruar organet e punësimit, respektivisht organet kompetente që të nxjerrin akt administrativ sipas kërkesës së ankuesve.

Të hedhura poshtë - janë vendime me të cilat është konstatuar se ankuesit paraprakisht nuk kanë ndërmarr veprime apo nuk i kanë shterur mjetet e brendshme të organi i punësimit, ankesat janë parashtruar jashtë afatit të përcaktuar ligjor për ankim, apo janë parashtruar nga personat të cilët në bazë të ligjit nuk kanë legjitimitetin e palës në procedurë.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka hedhur poshtë si të palejuara **515** ankesa.

Të shpallura jo-kompetent - janë vendime me të cilat është konstatuar se ankuesit nuk e kanë statusin e nëpunësit civilë apo kandidatit për marrjen e statusit në shërbimin civil.

Këshilli gjatë periudhës raportuese është shpallur jo kompetent për **86** ankesa.

Përfundimi i procedimit administrativ - janë vendime me të cilat është konstatuar se janë përmbushur kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ për shkak se ankuesi e ka tërhequr ankesën, objekti i vendosjes është bërë i pamundur apo i kotë, si dhe për çështjet e tjera të përcaktuara shprehimisht me ligj.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka vendosur për përfundimin e procedimit administrativ për **151** ankesa.

Të pezulluara - janë vendime me të cilat është konstatuar se gjatë procedurës janë paraqitur çështje zgjidhja e të cilave është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka vendosur për pezullimin e **6** procedurave.

5.1.1.6 Mënyra e vendosjes së ankesave sipas objektit të ankesave

Në këtë pjesë të raportit paraqiten të dhënat për mënyrën e vendosjes sipas objektit të ankesave.

Tabela 14. Mënyra e vendosjes sipas objektit të ankesave

Vendosja sipas objektit të ankesave	Të aprovuara	Të refuzuara	Të hedhura poshtë	Jo kompetent	Përfundim procedimi administrativ	Të aprovuara pjesërisht	Kthimi në rishqyrtim	Detyrim për vendosje	Të pezulluara	Gjithsej
Shkelje e të drejtës në pagë	2	14	153	7	10	1	3	2		192
Kontestim konkursi	97	198	190	18	93	12	5	1	4	618
Kompensim material	51	131	66	19	9	66	33	62	1	438
Masë disiplinore	65	46	8	10	4	7	38		1	179
Kërkesa nga marrëdhënia e punës	24	53	73	18	30	1	17	14		230
Ndërprerje e marrëdhënies së punës	4	10		9		2	5			30
Transferim	11	50	5	1	4	6	6	1		84
Vlerësim i punës	16	1	19	2	1	1	4	2		46
Pezullim nga marrëdhënies së punës	1	29	1	2						33
Gjithsej	271	532	515	86	151	96	111	82	6	1850


Nga gjithsej 1,850 ankesa të shqyrtuara gjatë periudhës raportuese, prej tyre janë shqyrtuar: 1,688 ankesa të vitit 2024, si dhe 162 ankesa të bartura nga vitet paraprake.

5.1.1.7 Vendosja e ankesave sipas institucioneve

Në këtë pjesë të raportit paraqiten të dhënat për mënyrën e vendosjes së ankesave të pranuar ndaj institucioneve të administratës qendrore, institucionet lokale, institucioneve kushtetuese dhe agjencive të pavarura, si dhe institucionet e sistemit të drejtësisë.

Tabela 15. Vendosja e ankesave sipas institucioneve

Nr.	Vendosja e ankesave sipas institucioneve	Numri i ankesave	Përqindja
1	Institucionet e administratës qendrore	1160	62.74%
2	Institucionet e administratës lokale	517	27.90%
4	Institucionet kushtetuese dhe agjencitë e pavarura	92	4.98%
5	Institucionet e sistemit të drejtësisë	81	4.38%
6	Gjithsej	1,850	100%

Diagrami 8. Paraqitja grafike e të dhënave si në tabelën nr.15

5.1.1.7.1 Ankesat e vendosura – Institucionet e Administratës Qendrore

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka vendosur për 1160 ankesa të parashtruara ndaj institucioneve të administratës qendrore dhe të njëjtat janë ndarë sipas mënyrës së vendosjes, të cilat pasqyrohen si në vijim:

Tabela 16. Mënyrat e vendosjes së ankesave të parashtruara ndaj institucioneve të administratës qendrore

Institucionet e Administratës Qendrore	Të aprovuara	Të refuzuara	Pjesërisht të aprovuara	Të hedhura poshtë	Shpallja jo kompetent	Kthimi në rishqyrtim	Përfundim procedimi	Detyrimi i organit administrativ për të nxjerr aktin administrativ	E pezulluar	Numri i ankesave të shqyrtuara
Ministria e Punëve të Brendshme	16	59	4	47	3	6	9	1		145
Ministria e Mbrojtjes	13	1	63	12				20		109
Ministria e Financave, Punës dhe Tran.	12	39	4	16	2	6	10	1		90
Shërbimi Korrektues i Kosovës	12	18	5	37	4	3	3	7		89
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	9	1		38	2		35			85
Zyra e Kryeministrit	4	20		25	1	9	3	5		67
Ministria e Industrisë, Ndër. dhe Treg.	16	13	4	14	1	2	2	2	1	55
Ministria e Shëndetësisë	6	13		15		6	1	6	1	48
Administrata Tatimore e Kosovës	9	14		1		10	3			37
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	4	14		8	1	3	1	4		35
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	15	9	1	4		3			1	33
Inspektorati i Punës	9	3	2	18			1			33
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Dias.	4	8		4	1	2	6	3		28

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	12	5	1	3		1	1	1		24
Agjencia e Punësimit	2	4	1	15			1			23
Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë	6	1	1	8		1	6			23
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë	2	6	2	10		1	1	1		23
Agjencia e Statistikave të Kosovës	3	3	1	9	1	1	1			19
Ministria e Drejtësisë	4	10		2			3	3		22
Agjencia e Shoqërisë së Informacionit				3			14	2		19
Agjencia Pyjore e Kosovës	2	6		5						13
Shërbimi Sprovues i Kosovës	1	6		1			4	1		13
Agjencia e Menaxhimit Emergjent		3		7	1					11
Kuvendi i Republikës së Kosovës	2	5		2		1				10
Agjencia Shtetërore e Arkivave	2	2		3	1					8
Agjencia e Kosovës për Pajisje dhe Produkte Meridionale		4		3		1				8
Ministria e Ekonomisë		2		3	2					7
Ministria e Zhvillimit Rajonal	4	2		1						7
Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor	3	1		1				2		7
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	1	3		1				1		6
Agjencia për ndihmë juridike Falas		4		1						5
Autoriteti i Aviacionit Civil	1	1				1				3
Instituti i Kosovës për administratë publike	1	1		1		1	1			5
Këshilli i Sigurisë së Kosovës				1						1
Dogana e Kosovës					2					2
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	2			1			1	1		5
Policia e Kosovës	1	3	1							5
Qendra e Studentëve					4					4
Universiteti i Prishtinës					3					3
Agjencia e Kosovës për Forenzik	1				1			1		3
Ministria për Komunitete dhe Kthim		1		1			1			3
Autoriteti rregullator për shërbimet e ujit	2					1				3
Zyra e Rregullatorit për Energji	1	1								2
Autoriteti Kombëtar i kualifikimeve				2						2
Instituti Kombëtar i shëndetësisë publike					2					2
Agjencia për Menaxhimin e Pasurisë së Konfiskuar ose Sekuestruar		1		1						2
Sekretariati i KPMSHCK-së		1		1						2
Universiteti i Mitrovicës					1					1
Universiteti i Pejës	1									1
Presidenca e Kosovës						1				1
Akademia e Kosovës për Siguri Publike	1									1
Agjencia e Akreditimit të Kosovës	1									1
Biblioteka Kombëtare e Kosovës					1					1
Muzeu i Kosovës					1					1
Autoriteti rregullator i hekurudhave				1						1
Qendra Kryesore e mjekësisë familjare në Ferizaj					1					1
Qendra Kryesore e mjekësisë familjare në Malishevë					1					1
Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare							1			1
Gjithsej	185	288	90	326	37	60	109	62	3	1160

5.1.1.7.2 Ankesat e vendosura – Institucionet e Administratës Lokale

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka vendosur për 517 ankesa të parashtruara ndaj institucioneve të administratës lokale dhe të njëjtat janë ndarë sipas mënyrës së vendosjes, të cilat pasqyrohen si në vijim:

Tabela 17. Mënyrat e vendosjes së ankesave të parashtruara ndaj institucioneve të administratës lokale

Institucionet e Administratës Lokale	Të aprovuara	Të refuzuara	Pjesërisht të aprovuara	Të hedhura poshtë	Shpallja jo kompetent	Përfundim i procedimit administrativ	Ri-Shqyrtim	Detyrimi i organit admin. për të nxjerr aktin admin.	E Pezulluar	Numri i ankesave të shqyrtuara
Komuna e Prishtinës	7	49		15	10	9	1	1		92
Komuna e Suharekës	1	26		3			24			54
Komuna e Mitrovicës së Jugut	2	8		22	1	2		1		36
Komuna e Gjilanit	6	18		4	1	2	1			32
Komuna e Kamenicës	8	5	1	8	4	3	1			30
Komuna e Klinës	2	9	1	8			2	1		23
Komuna e Fushë Kosovës	2	1		16	2					21
Komuna e Shtimes	3	6		4	6	1		1		21
Komuna e Obiliqit	3	2		11		2	1			19
Komuna e Pejës		6		10	2	1				19
Komuna e Prizrenit	2	3		8	3	2		1		19
Komuna e Ferizajt	3	6		3		1				13
Komuna e Vitisë	4	1	1	2	1	4				13
Komuna e Istogut		5		5						10
Komuna e Vushtrrisë	1	3	1	2		1				8
Komuna e Podujevës	1	4		1		1				7
Komuna e Drenasit	3	2		1						6
Komuna e Skenderajt		1		2			1			4
Komuna e Deçanit				1		1				2
Komuna e Malishevës	1			2						3
Komuna e Rahovecit	3	2		3			1			9
Komuna e Mitrovicës së Veriut	1	3		5						9
Komuna e Ranillukut	2	1		6						9
Komuna e Dragashit		1			5	2			1	9
Komuna e Kaçanikut		1		6						7
Komuna e Lipjanit	2	2		2	1					7
Komuna e Hanit të Elezit	2	2		2						6
Komuna e Leposaviqit	1	1			3					5
Komuna e Junikut	2	2				1				5
Komuna e Gjakovës		2		1		1	1			5
Komuna e Kllokotit	1			1	2					4
Komuna e Shtërpçës	1			3						4
Komuna e Zveçanit				1			1			2
Komuna e Novobërdës		1								1
Komuna e Graçanicës				1						1
Komuna e Parteshit				1						1
Komuna e Mamushes		1								1
Gjithsej	64	174	4	160	41	34	34	5	2	517

5.1.1.7.3 Ankesat e vendosura – Institucionet Kushtetuese dhe Agjencitë e Pavarura

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka vendosur për 92 ankesa të parashtruara ndaj institucioneve dhe agjencive të pavarura si dhe të njëjtat janë ndarë sipas mënyrës së vendosjes, të cilat pasqyrohen si në vijim:

Tabela 18. Mënyrat e vendosjes së ankesave të parashtruara ndaj institucioneve dhe agjencive të pavarura

Institucionet dhe agjencitë e pavarura	Të aprovuara	Të refuzuara	Pjesërisht të aprovuara	Të hedhura poshtë	Shpallja jo kompetent	Kthimi në rishqyrtim	Përfundim procedimi	Detyrimi i organit admin. për të nxjerr aktin admin.	E pezulluar	Numri i ankesave të shqyrtuara
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	4	7		4			5			20
Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror	1	6		4	4	3		1		19
Agjencia Kosovare e Privatizimit	1	10		2		2		1		16
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës		2		3		2				7
Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit	5	1								6
Agjencia për Informim dhe Privatësi		5		1						6
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	1	1		2						4
Agjencia për Krahxim dhe Verifikim të Pronës	1	1			1	1				4
Institucioni i Avokatit të Popullit				1					2	3
Komisioni i Pavarur për Media		1					2			3
Organi Shqyrtues i Prokurimit	1	1								2
Akademia e Drejtësisë				1						1
Zyra Kombëtare e Auditimit				1						1
Gjithsej	14	35	0	19	5	8	7	2	2	92

5.1.1.7.4 Ankesat e vendosura – Institucionet e Sistemit të Drejtësisë

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka vendosur për 81 ankesa të parashtruara ndaj institucioneve të sistemit të drejtësisë si dhe të njëjtat janë ndarë sipas mënyrës së vendosjes, të cilat pasqyrohen si në vijim:

Tabela 19. Mënyrat e vendosjes së ankesave të parashtruara ndaj institucioneve të drejtësisë

Institucionet e sistemit të drejtësisë	Të aprovuara	Të refuzuara	Pjesërisht të aprovuara	Të hedhura poshtë	Shpallja jo kompetent	Kthimi në rishqyrtim	Përfundim procedimi	Detyrimi i organit admin. për të nxjerr aktin admin.	E pezulluar	Numri i ankesave të shqyrtuara
Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	4	25	1	5	2	3	1	11		52
Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës	4	10	1	6		6		2		29
Gjithsej	8	35	2	11	2	9	1	13	0	81

5.1.2 FUNKSIONI I MONITORIMIT

Përveç funksionit të shqyrtimit dhe vendosjes së ankesave, po ashtu gjatë periudhës raportuese Këshilli e ka vijuar ushtrimin e funksionit të monitorimit siç përcaktohet me dispozitat e nenit 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe nenin 20 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke e mbikëqyrë zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në fushat si në vijim:

Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve; Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit; Procedurat disiplinore; Procedurat e ankesave; Procedurat e vlerësimit; Procedurat e pushimeve; Procedurat e transferimit; Të dhënat lidhur me përfaqësimin etnik, gjinor dhe personave me aftësi të kufizuara; Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës; Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik; Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale apo është i dënuar me vendim të gjykatës; Rastet e ngacmimit seksual; Trajnimi i nëpunësve civil; Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet e nëpunësve civil; Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit.

Në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregullores Nr. 04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike, datë 27.03.2024, përmes Vendimit me numër 1698/2024 është aprovuar Plani i Monitorimit për vitin 2024.

Rrjedhimisht, duke u bazuar në planin vjetor të monitorimit, gjatë vitit 2024 janë realizuar tetë (8) vizita të rregullta në institucione të administratës publike. Njëkohësisht gjatë kësaj periudhe është realizuar edhe një vizita me kërkesë të Institucionit në institucionet e administratës publike.

Gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në institucionet përkatëse janë evidentuar rreth 33 shkelje të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, dhe për shkeljet e evidentuara janë dhënë 32 rekomandime për zyrtarët përgjegjës të institucioneve të cilat janë monitoruara.

Në vijim janë listuar institucionet së bashku me numrin e të gjeturave dhe rekomandimeve gjatë monitorimit të rregullt si dhe atij të jashtëzakonshëm:

Tabela 20. Institucionet, numri i të gjeturave dhe rekomandimeve në monitorime të rregullta

Nr.	Institucionet e administratës publike	Numrit i të gjeturave	Numri i rekomandimeve
1	Ministria e Financave Punës dhe Trasfereve	1	1
2	Ministria e Shëndetësisë	5	4
3	Ministria e Kulturës, Rinis dhe Sportit	5	5
4	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	8	8
5	Ambasada e Republikës së Kosovës në Holandë, Austri dhe Konsullata e Cyrihut - Zvicër	4	4
6	Komuna e Gjilanit	6	6
7	Komuna e Skenderajt	4	4
	Gjithsej	33	32

5.2 Plani vjetor i punës për vitin 2025

Siç jeni në dijeni me miratimin e ligjit nr.08/L-180 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i cili ka hyrë në fuqi nga data 17 tetor 2024, janë paraqitur rrethana të reja për faktin se me këtë ligj është rritur numri i Anëtarëve, nga shtatë (7), në pesëmbëdhjetë (15) Anëtar të Këshillit, andaj është draftuar plani vjetor i Punës për vitin 2025 por nuk është miratuar pasi që sipas obligimit ligjor kërkohet miratimi i tij nga Këshilli, i cili për momentin ka vetëm Kryetarin dhe tre Anëtar.

Me qëllim të përmbushjes së misionit dhe vizionit për mbikëqyrjen dhe garantimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil është përgatitur draft plani i punës me objektiva kryesore, si në vijim: Shqyrtimi i të gjitha ankesave të nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbim civil; Mbikëqyrja dhe vlerësimi i respektimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil; Funksionalizimi i plotë i strukturës organizative; Përditësimi i akteve nënligjore të Këshillit; Avancimi i bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare; Forcimi i kapaciteteve profesionale të Këshillit; Ngritja e mëtejme e transparencës të Këshillit; Përfaqësimi në procedurë gjyqësore.

5.2.1 Bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare

Gjatë periudhës raportuese, rendësi e veçantë i është kushtuar vendosjes dhe avancimit të bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet vendore është vijuar realizimi i vizitave në institucione të ndryshme të administratës publike të nivelit qendror, lokal, si dhe institucionet e sistemit të drejtësisë.

Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Komisionerin e Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil të Republikës së Shqipërisë, janë organizuar tre (3) takime për planin e punës, me qëllimi të shkëmbimit të ekspertizave, eksperiencave dhe praktikave më të mira me synimin për të ofruar një mbikëqyrje më profesionale e cila do të garantojë respektimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në të dy vendet përkatëse.

Këshilli po ashtu ka vijuar të bashkëpunojë me partnerët ndërkombëtarë, siç është SIGMA dhe OSBE.

Bashkëpunimi më përfaqësuesit e SIGMA-së konsiston në çështjet e diskutimit të përbashkët lidhur me zbatimin e legjislacionit për zyrtarët publikë si pjesë e reformës së administratës publike në Kosovë si dhe legjislacionin sekondar të Këshillit sa i përket monitorimeve të institucioneve të administratës publike.

Ndërsa bashkëpunimi me OSBE-në, ka vazhduar me përkrahjen e aktiviteteve të caktuara siç është trajnimi në fushën e TI-së, përditësimi i akteve nënligjore, si dhe organizimi i dy (2) punëtorive në Komunën e Gjilanit, Ranillukut, Ferizajt, Parteshit, Kamenicës, Vitisë, Pejës, Gjakovës, Istogut, Klinës dhe Deçanit. Pjesëmarrës kanë qenë Shërbyesit civil dhe Udhëheqësit e Komunave ku temë ka qenë zbatimi i legjislacionit për Shërbimin Civil si dhe Sfidat. Ky projekt do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2025 në të gjitha Komunat e Republikës së Kosovës.

5.3 Zbatimi i vendimeve

5.3.1 Zbatimi i vendimeve nga organet e punësimit

Sipas nenit 21 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendimet e Këshillit janë vendime administrative të formës së prerë dhe zbatohen nga zyrtaret e nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës.

Zbatimi i vendimit duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit. Moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i institucionit, paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës.


Këshilli në ushtrimin e funksionit të shqyrtimit dhe vendosjes se ankesave, gjatë periudhës raportuese, ka lëshuar 560 vendime për të cilat organet e punësimit kanë qenë të obliguara për zbatim. Prej tyre 367 vendime përfundimtare dhe 193 vendime të ndërmjetme.

Nga procesi i mbikëqyrjes se zbatimit të vendimeve rrjedh se zbatimi i vendimeve përfundimtare është si në vijim:

Tabela 21. Zbatimi i vendimeve përfundimtare

Vendime përfundimtare	Numri i vendimeve	Vendime të zbatuara	Vendime të pa zbatuara	Vendime në proces të zbatimit	Numri i vendimeve të pezulluara
Të aprovuara	271	234	0	37	0
Pjesërisht të aprovuara	96	86	0	10	0
Gjithsej	367	320	0	47	0


Diagrami 8. Paraqitja grafike e të dhënave si në tabelën nr.21



Ndërsa nga analizimi i të dhënave të mbledhura rezulton se të vendimet e ndërmjetme janë zbatuara nga institucionet përkatës të administratës publike, të cilat pasqyrohen si në vijim:

Tabela 22. Zbatimi i vendimeve të ndërmjetme

Vendime të ndërmjetme	Numri i vendimeve	Vendime të zbatuara	Vendime të pa zbatuara	Vendime në proces të zbatimit	Numri i vendimeve të pezulluara
Kthimi në rishqyrtim	111	97	0	14	0
Detyrim për vendosje	82	75	0	7	0
Gjithsej	193	172	0	21	0

Diagrami 9. Paraqitja grafike e të dhënave si në tabelën nr.22

5.3.2 Përfaqësimi dhe vendimet e gjykatës

Vendimet e Këshillit janë vendime administrative të formës së prerë. Rrjedhimisht, me dispozitat e nenit 22 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përcaktohet se kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit të përcaktuar me dispozitat e ligjit për konfliktin administrativ. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka pranuar 468 ftesa për seancë gjyqësore dhe 246 aktvendime për përgjigje në padi. Po ashtu gjatë kësaj periudhe ka pranuar 358 aktgjykime dhe 113 aktvendime.

Nga Gjykata Themelore - janë pranuar gjithsej 343 vendime, nga të cilat 275 aktgjykime dhe 68 aktvendime, të pasqyruara si në vijim:

Aktgjykime:

- Me 56 aktgjykime janë aprovuar paditë e paditësve dhe lëndët janë kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje në Këshill;
- Me 16 aktgjykime janë aprovuar paditë e paditësve dhe janë anuluar vendimet e Këshillit;

- Me 7 aktgjykime janë aprovuar pjesërisht paditë e paditësve dhe janë anuluar vendimet e Këshillit;
- Me 169 aktgjykime janë refuzuar paditë e paditësve dhe rrjedhimisht janë vërtetuar vendimet e Këshillit;
- Me 26 aktgjykime janë anuluar njoftimet e administratës së Këshillit, dhe është obliguar Këshilli që ti shqyrtoj ankesat e pavendosura të viteve paraprake kur Këshilli nuk ishte funksional.
- Me 1 aktgjykim është shtyrë ekzekutimi i vendimeve të Këshillit;

Aktvendime:

- Me 11 aktvendime janë hedhur poshtë paditë e paditësve dhe janë vërtetuar vendimet e Këshillit.
- Me 3 aktvendim është refuzuar padia e paditësit;
- Me 21 aktvendime janë pezulluar procedurat- tërhequr gjyqësore;
- Me 13 aktvendime janë refuzuar kërkesat për shtyrje të ekzekutimit të vendimeve të Këshillit;
- Me 4 aktvendime është shtyrë ekzekutimi i vendimeve të Këshillit;
- Me 3 aktvendim janë hedhet poshtë shtyrja ekzekutimit, vendimi gjyqësor;
- Me 5 aktvendime gjykata është shpall jo kompetente për të vendosur lidhur me padinë e paditësve.
- Me 3 aktvendime janë aprovuar ekspertiza financiare
- Me 1 aktvendim caktohet përmbarimi
- Me 4 të tjera si i njihet qasja në dokumente, rihapet procedura dhe lejohet zgjerimi i padis.

Nga Gjykata e Apelit - janë pranuar 96 vendime nga të cilat 62 aktgjykime dhe 34 aktvendime, të pasqyruara si në vijim:

Aktgjykime:

- Me 45 aktgjykime janë refuzuar ankesat e ushtruara ndaj vendimeve të Këshillit;
- Me 13 aktgjykime janë refuzuar ankesat e Këshillit;
- Me 3 aktgjykime janë aprovuar ankesat e Këshillit
- Me 1 aktgjykime janë aprovuar ankesat e palëve dhe është vendosur në mënyrë meritorë.

Aktvendime:

- Me 3 aktvendime është aprovuar ankesa e palës dhe lënda është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë;
- Me 1 aktgjykime është aprovuar ankesat e palëve dhe është vendosur në mënyrë meritorë.
- Me 16 aktvendime janë refuzuar ankesat e palëve lidhur me shtyrjen e zbatimit të vendimit të Këshillit;
- Me 4 aktvendime janë miratuar ankesat e palëve janë kthyer në rishqyrtim shkallës së parë;
- Me 3 aktvendime janë miratuar ankesat e Këshillit kthyer në rishqyrtim shkallës së parë;
- Me 2 aktvendime janë aprovuar ankesa e Këshillit
- Me 3 aktvendim është refuzuar ankesa e palës;
- Me 2 aktvendime janë hedhë poshtë ankesat e palëve;

Nga Gjykata Supreme - janë pranuar 31 vendime, nga të cilat 21 aktgjykime dhe 10 aktvendime, të pasqyruara si në vijim:

Aktgjykime:

- Me 16 aktgjykime janë refuzuar kërkesat e palëve;
- Me 2 aktgjykime është aprovuar kërkesa e palës dhe lënda është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.
- Me 1 aktgjykime është aprovuar ankesa e Këshillit
- Me 1 aktgjykime është miratuar ankesa e palës dhe lënda kthehet rishqyrtim gjykatës Apelit
- Me 1 aktgjykime aprovohet ankesa e Këshillit dhe kthehet rishqyrtim gjykatës Apelit

Aktvendime:

- Me 2 aktvendime janë aprovuar kërkesa e palës.
- Me 1 aktvendim është aprovuar dhe lënda kthehet shkallës së parë;
- Me 7 aktvendime është hedhë poshtë kërkesa e palës.

Nga Gjykata themelore Gjakovë - janë pranuar 1 vendime-aktvendime, të pasqyruara si në vijim:

- Me 1 aktvendime është hapet konflikt i kompetencës

5.4 Sfidat e vitit 2024

Sfidat të cilat kanë vijuar ta përcjellin punën e Këshillit gjatë periudhës raportuese kanë të bëjnë me përbërjen jo të plotë të Këshillit, mungesën e buxhetit të nevojshëm, numrin e vogël të personelit mbështetës dhe hapësirat për punë.

Funksionimi në përbërje jo të plotë

Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka miratuar Ligjin Nr.08/L-180 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit NR. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi nga data 17.10.2024, ndërsa përmes të njëjtit ligj janë ndryshuar kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit, kurse numri i anëtarëve është përcaktuar të jetë pesëmbëdhjetë (15). Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 08.11.2024 ka hapur konkursin për pranimin dhe emërimin e dhjetë (10) anëtarëve të Këshillit, i cili deri në periudhën e fundit të raportimit 30.03.2025 nuk ka përfunduar.

Duke marrë parasysh dispozitat e nenit 40 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, tani ka paraqitur vështirësi ligjore ngase duke marrë parasysh numrin e përcaktuar prej 15 anëtarësh sipas Ligjit Nr.08/L-180 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit NR. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli nuk ka kuorum të mbaj mbledhje të rregullta/jashtëzakonshme sikurse përcaktohet me aktet e veçanta dhe as të nxjerrë vendime të mbledhjeve të Këshillit, pasi që po ashtu me datë 27 dhjetor 2024 njëri nga anëtarët e Këshillit, është dekretuar Prokuror i Shtetit, nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhe aktualisht kanë mbetur vetëm katër (4) anëtarë.

Mungesa e buxhetit

Me Ligjin NR. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, buxheti i Këshillit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ka qenë vetëm 100,000.00€, buxhet me të cilin nuk kanë mundur të përfshihen nevojat kryesore dhe planifikimi nuk ka mundur të përfshijë kostot financiare që janë paraparë në objektivat kryesore në kuadër të mandatit ligjor të Këshillit.

Buxheti i lejuar për vitin 2025 prej 130,000.00€ në mallra dhe shërbime ishte një planifikim dhe buxhet tejet minimal për shpenzimet administrative që do të bartë KPMSHCK ku nuk mund të përfshihen objektivat kryesore, andaj Këshilli ka kërkuar rritjen e buxhetit në mallra dhe shërbime, buxhet shtesë prej 55,000.00 €, por kërkesa nuk është realizuar.

Mungesa e numrit të nevojshëm të punëtorëve të rinj

Në periudhën raportuese një ndër sfidat kryesore për ushtrimin e funksioneve të përcaktuara ligjore ishte mungesa e burimeve të mjaftueshme njerëzore.

Mungesa e buxhetit për rekrutimin e punëtorëve të rinj e ka vështirësuar ushtrimin e funksionit të shqyrtimit të ankesave në kuptim të trajtimit të tyre në afatin ligjor prej 45 ditësh, siç përcaktohet me nenin 17 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Kjo për faktin se gjatë kësaj periudhe kishim për shqyrtim gjithsej 2,332 ankesa, numër ky mjaft i lartë në raport me kapacitetet në dispozicion për shqyrtimin e tyre.

Siç jeni në dijeni me miratimin e ligjit nr.08/L-180 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i cili ka hyrë në fuqi nga data 17 tetor 2024, janë paraqitur rrethana të reja dhe rrjedhimisht edhe kërkesa shtesë buxhetore, për faktin se me këtë ligj është rritur numri i anëtarëve, nga shtatë (7), në pesëmbëdhjetë (15).

Andaj në vlerësimin tonë është më se e nevojshme që të kemi buxhetin e ndarë dhe rrjedhimisht planifikimin e pagave për tetëmbëdhjetë (18) zyrtar të cilët do të ndihmojnë anëtarët e Këshillit për shqyrtimin e ankesave, monitorimin e institucioneve publike si dhe zyrtarë të tjerë administrative dhe financiar të paraparë sipas **Rregullores nr.01/2023** për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është miratuar në mbledhjen e mbajtur me datë 19.12.2023 me Vendimin VM/2023 me nr.7565/2023.

Hapësirat e punës

Këshilli është i vendosur në një hapësirë të vogël në kuadër të ndërtesës së Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Kjo hapësirë e punës nuk është e mjaftueshme në raport me numrin e stafit aktual dhe njëkohësisht kushtet e punës janë tejet të vështira dhe si i tillë ambienti nuk krijon mundësi për punë efektive.

Krijimi i kushteve të punës përmes sigurimit të hapësirave të nevojshme ku stafi mbështetës ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, si dhe sigurimi i hapësirave për mbajtjen e seancave publike me rastin e shqyrtimit të ankesave dhe seancave profesionale, do të lehtësonte ushtrimin e mandatit kushtetues dhe ligjor dhe rrjedhimisht do të jetë garanci për punë efektive dhe efikase.

6 VLERESIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06 /L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe duke marr për bazë të dhënat e grumbulluara nga ushtrimi i funksioneve kushtetuese dhe ligjore, gjegjësisht funksioni i shqyrtimit të ankesave dhe funksioni i monitorimit të institucioneve të administratës publike, Këshilli ka arritur që të nxjerrë një vlerësim të përgjithshëm lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil si dhe të paraqes rekomandime për institucionet kompetente me qëllim të përmirësimit.

Vlerësimi i zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil është bërë në fusha të caktuara duke marr si indikator numrin e ankesave të pranuar dhe të vendosura si dhe të gjeturat në procesin e monitorimit të institucioneve të administratës publike.

Rekomandimet do të jepen në frymën e zbatimit të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe akteve nën ligjore për zbatimin e tij.

6.1 ORGANIZIMI I BRENDSHËM

Këshilli bazuar në të dhënat e siguruar nga ushtrimi i funksionit të shqyrtimit dhe vendosjes së ankesave si dhe funksionit të monitorimit vlerëson se institucionet e administratës publike nuk kanë arritur të zbatojnë në nivel të duhur legjislacionin e aplikueshëm lidhur me organizimin e brendshëm.

Ligji Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura përcakton rregullat për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura të themeluara nga Kuvendi i Kosovës. Rrjedhimisht me Rregulloren (QRK) Nr.01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës janë përcaktuar rregullat, standardet dhe procedurat për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm të Institucioneve të Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, ndërsa sipas nenit 16 të kësaj rregulloreje të gjitha institucionet e administratës shtetërore kanë qenë të obliguara që në afat kohor prej gjashtë (6) muajsh të hartojnë Rregulloret përkatëse për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Nga të dhënat e siguruar gjatë ushtrimit të funksionit të monitorimit rrjedh se shumica e institucioneve të administratës shtetërore, përkundër obligimeve ligjore, nuk kanë arritur që të nxjerrin rregullore për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Për me shumë vonesat e shprehura në miratimin e rregulloreve për organizimin e brendshëm janë vërejtur edhe në institucionet të cilat janë fuzionuar/bashkuar sipas Vendimit Nr. 07-v-005 të datës 03.02.2020 të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Si rrjedhojë kjo situatë ka sjellë dualizëm të pozitave të punës dhe ka bartur pasoja administrative në kuptim të menaxhimit dhe përmbushjes së detyrave funksionale të punës si dhe ngarkesa buxhetore.

Rekomandime:

Duke marr parasysh konstatimet e mësipërme në këtë fushë, rekomandohen:

1. *Institucionet e Administratës Publike dhe Agjencitë e Pavarura, pa vonesë të ndërmarrin veprime të duhura ligjore për hartimin e Rregulloreve për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.*

6.2 KLASIFIKIMI I VENDEVE TË PUNËS DHE PAGAT E NËPUNËSVE CIVIL

Nga të dhënat e prezantuara në këtë raport vihet re se janë pranuar 214 ankesa për shkak të shkeljes të së drejtës në pagë që kanë të bëjnë me ekuivalentimin e koeficienteve apo klasifikimin e vendeve të punës e që ndërlidhet me kalimin në sistemin e ri të pagave sipas Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik. Këto raste përfaqësojnë mbi 10.01% të ankesave dhe kanë të bëjnë me shqetësimin e nëpunësve civilë për diskriminim apo trajtim jo të barabartë në realizimin e të ardhurave personale.

Rrjedhimisht nga ushtrimi i funksionit të shqyrtimit të ankesave është vlerësuar se rritja e numrit të ankesave me këtë objekt ankimor ka të bëjë drejtpërdrejtë me vonesat procesin e klasifikimit të vendeve të punës nga institucionet, ngase kjo ka qenë obligative sipas Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Këshilli, ka konstatuar se vonesa për të finalizuar procesin e klasifikimit dhe sistematizimit të vendeve të punës në shërbimin civil, ka bërë që ende të mos kemi një sistem të standardizuar të pagave dhe për pasojë është vijuar që nëpunësit civilë edhe në periudhën raportuese.

Këshilli e ka mirëpritur hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, në shkurt të vitit 2023, qëllimi i të cilit është që të krijojë një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik dhe të krijojë një sistem të pagave dhe shpërblimeve, transparent dhe të menaxhueshëm ku elementi kryesor është paga bazë. Mirëpo fillimi i zbatimit të menjëhershëm i këtij ligji, pa vijuar procedurat e klasifikimit të vendeve të punës, siç parashihet me legjislacionin e aplikueshëm për Shërbimin Civil, ka sjell situatë të njëjtë të pakënaqësisë të nëpunësve civilë.

Rekomandime:

Duke marr parasysh konstatimet e mësipërme në këtë fushë, rekomandohet:

1. *Institucionit e administratës publike bazuar në Rregulloren (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, dhe Vendimin....e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të ndërmarrin veprimet për përfundimin e klasifikimit të vendeve të punës në shërbimin civil, përshtatshmërisht me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe rregulloreve të organizimin e brendshëm.*

6.3 PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL

Sipas të dhënave të prezantuara po ashtu rezulton se vendin e parë për nga numri i ankesave të pranuar zënë ankesat ndaj procedurave të rekrutimit ku gjithsej janë 722 ankesa e parashtruara. Këto raste përfaqësojnë mbi 33.78% të ankesave dhe kanë të bëjnë me

shqetësimet e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, se u janë bërë padrejtësi apo janë lejuar shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar parimet e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil.

Si shkelje më të shpeshta ndërlidhur me procedurat e rekrutimit janë evidentuar:

- *përcaktimi i kriterëve të përgjithshme formale në kundërshtim me legjislacionin përkatës;*
- *llogaritja e përvojës së punës së kandidatëve për pranim në shërbimin civil dhe vlerësimi i jetëshkrimit në kundërshtim me kriteret e përgjithshme formale;*
- *themelimi i Komisioneve të Pranimit në kundërshtim me legjislacionin në fuqi;*
- *tejkalimi i afateve ligjore lidhur me përfundimin e procedurave të rekrutimit;*

Këshilli, nga analizimi i të dhënave në fushën përkatëse ka gjetur se tek procedurat e rekrutimit rezulton të jetë përcaktimi jo i saktë i kriterëve të përgjithshme formale (arsimimi i kërkuar dhe përvoja e punës) ngase në shumë raste është bërë në kundërshtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil. Rrjedhimisht në disa raste është evidentuar se institucionet e administratës publike kanë dështuar t'i përcaktojnë në mënyrë të saktë dhe të qartë dokumentet/dëshmitë lidhur me kërkesat e përgjithshme formale siç parashihet me nenin 9 të Ligjit Nr. 06/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 5 të Rregullores (QRK) Nr. 15/23 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil.

Këshilli ka konstatuar se edhe në vitin 2024 institucionet e administratës publike kanë vijuar që të vërtetojnë në mënyrë të gabuar përvojën e punës për kandidatet të cilët i janë nënshtruar procedurave të rekrutimit. Ky fenomen është vërejtur sidomos në rastet kur përvoja e punës i përkiste sektorit privat, ngase përvoja e deklaruar nga aplikuesit nuk dëshmohej me dokumentet përkatëse, respektivisht kontratë pune apo vërtetim nga punëdhënësi të mbështetur edhe me dokumente nga autoritetet kompetente, sikurse është Administrata Tatimore e Kosovës apo Fondi i Kursimeve Pensionale.

Gjatë ushtrimit të funksionit të shqyrtimit të ankesave në shume raste është gjetur se vlerësimi i jetëshkrimit është bërë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara sipas konkursit, respektivisht vlerësimet e jetëshkrimit nuk konsistojnë me vlerësimin e nivelit të arsimit, përvojës së punës dhe trajnimeve që lidhen me vendin e punës për të cilën zhvillohej procedura. Për sa me sipër është vepruar në kundërshtim me Rregulloren (QRK) Nr. 15/23 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ngase vlerësimi i jetëshkrimit është bërë edhe për fushat të cilat nuk ka kanë qenë kriteret e përgjithshme formale të konkursit.

Këshilli po ashtu ka gjetur edhe raste ku institucionet e administratës publike nuk ka respektuar afatet procedurale të përfundimit të procedurave të rekrutimit, gjegjësisht nuk ne shumicën e rasteve nuk janë ndërmarr veprimet juridike për vazhdimin e afatit të procedurës administrative kur kjo është komplekse e siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Rekomandime:

Duke marr parasysh konstatimet e mësipërme në këtë fushë, rekomandohet që:

1. *Institucionet e Administratës Publike, me rastin e përgatitjes dhe shpalljes se konkurseve, t'i përcaktojnë kriteret e përgjithshme formale për pozitat përkatëse në mënyrë të saktë dhe në pajtueshmëri me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në*

Shërbimin Civil dhe Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil;

2. *Njësitë përgjegjëse, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Pranimin në Shërbimin Civil dhe Rregullore (QRK) Nr.05/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Pranimin në Shërbimin Civil, me rastin e shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve lidhur me përvojën e punës në sektorin privat të kenë parasysh që e njëjta të shoqërohet me dokumente përkatëse, gjegjësisht kontratë pune apo vërtetim nga punëdhënësi të mbështetur edhe me dokumente nga autoritetet kompetente sikurse është Administrata Tatimore e Kosovës apo Fondi i Kursimeve Pensionale.*
3. *Njësitë përgjegjëse dhe Komisionet e Pranimeve, duhet të ndërmarrin veprimet procedurale për respektimin e afateve procedurale për përfundimin e procedurës administrative gjegjësisht procedurës së rekrutimit, ngase mos respektimit i procedurave mund të përbëjë shkak për inicim të procedurës disiplinore.*
4. *Anëtarët e Komisionit të Pranimi, duhet të ndërmarrin veprimet për respektimin në plotësin të dispozitave përkatëse për pranim në shërbimin civil, ngase mos respektimin i procedurave ligjore me rastin e rekrutimit përbën shkak për shkelje të rënda disiplinore për Komisionin e Pranimi.*

6.4 USHTRIMI I POZICIONEVE TË PUNËS ME USHTRUES DETYRE

Këshilli, gjatë ushtrimit të funksioneve kushtetuese dhe ligjore, ka gjetur se në institucionet e administratës publike ekziston një numër i konsiderueshëm i pozitave të lira të punës, të cilat ushtrohen përmes zëvendësuesve/ushtguesve të detyrës.

Me rastin e analizimit të vendimeve për caktimin e zëvendësuesve/ ushtguesve të detyrës, është vërejtur se në shumicën e rasteve caktimi i tyre është bërë mbi bazën e dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.

Këshilli vlerëson se ushtrimi i pozitave të lira të punës me zëvendësues/ushtgues të detyrës është bërë në kundërshtim me ligjin material, sepse:

Me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, përkatësisht nenet 18, 19 dhe 20 parashihet mundësia e zëvendësimit të nëpunësit civil të nivelit drejtues në rastet kur i njëjti përkohësisht nuk mund të ushtroj detyrën për arsye të ndryshme si p.sh gjendet në pushim vjetor, pushim mjekësor, vizitë jashtë vendi, etj, nga rrjedh se kjo bazë ligjore nuk i referohet rasteve kur pozita e punës në shërbim civil mbetet pozitive e lirë, mirëpo i referohet vetëm zëvendësimit të përkohshëm të nëpunësit civil të përhershëm, e i cili, për arsyet e lartcekura, përkohësisht nuk mund ta ushtroj detyrën e tij të punës.

Sipas Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë respektivisht me nenin 35 është paraparë që në rast se një pozitive e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtguesen/in e detyrës për pozitën e lirë për një periudhë kohore maksimale prej dymbëdhjetë (12) muajsh sipas rrethanave të përcaktuar me paragrafin 3 të këtij neni, rrjedhimisht sipas këtij ligji nuk është paraparë termi zëvendësues dhe si i tillë çdo vendim për caktim të zëvendësuesit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji është i paligjshëm sepse zëvendësimi i një pozitive të lirë nuk mund

të bëhet sipas Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.

Rekomandime:

Duke marr parasysh konstatimet e mësipërme në këtë fushë, rekomandohen:

1. *Titullarët e institucioneve të administratës publike, që të ndërmarrin veprime të shpejta për plotësimin e pozitave të lira të punës të cilat ushtrohen me ushtrues detyre, në mënyrë që plotësimi i pozitave të lira të bëhet në pajtim me procedurën e përcaktuar me dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë.*
2. *Përgjashtimisht, në rastet kur paraqitet nevoja për caktimin e një ushtruesi të detyrës, titullarët e institucioneve të administratës publike të veprojnë në pajtim me dispozitat e nenit 35 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, dhe të respektohet kohëzgjatja e ushtrimit të pozitave me ushtruesi të detyrës.*
3. *Titullarët e institucioneve të administratës publike, që të ndërmarrin veprime që me rastin e caktimit të ushtruesve të detyrës të respektohet kriteret e parashikuara me nenin 35 paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë.*
4. *Çdo vendim i marrë nga ushtruesja/i i detyrës, pas kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni, është i paligjshëm.*

6.5 PROCEDURAT DISIPLINORE

Numri i ankesave të pranuar nga nëpunësit civilë në këtë fushë përfaqëson 8.27% të numrit të përgjithshme të ankesave të pranuar gjatë periudhës raportuese. Për dallim nga viti 2023, kur numri i ankesave të pranuar ishte 10.98%, nga rrjedh se numri i ankesave në këtë fushë është zbritur për 2.71% në vitin 2024.

Në bazë të dhënave të grumbulluara nga ushtrimi i funksioneve kushtetuese dhe ligjore, Këshilli, si shkelje më të shpeshta ndërlidhur me këtë fushë, ka evidentuar:

- *inicimi i procedurës disiplinore nga organi jo kompetent;*
- *shqiptimi i masave disiplinore në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore;*
- *përgatitja e vendimeve në kundërshtim me strukturën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ;*
- *shkeljet procedurale lidhur me mbajtjen e seancave disiplinore dhe njoftimin me te drejtat e palëve ne procedure;*
- *zëvendësimi i anëtarëve të Komisionit Disiplinor pa ndonjë arsye si dhe mos shqyrtimi i rasteve të përgjashtimit nga procedura administrative;*

Me dispozitat e Ligjit përkatës për Zyrtarët Publikë, përcaktohet se Komisioni disiplinor fillon procedurën me kërkesë të mbikëqyrëses/it të drejtpërdrejtë të nëpunëses/it civil; bazuar në të gjeturat dhe/apo rekomandimet e çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditimi, ose të çdo zyrtareje/i tjetër brenda institucionit, si dhe me kërkesën e qytetares/it; me nismën e çdo anëtare/i të komisionit, mbi bazën e dyshimit të bazuar për kryerjen e një shkeljeje disiplinore.

Këshilli edhe gjatë periudhës raportuese ka hasur në raste kur procedura disiplinore është

iniciuar nga organet jo kompetente. Është vërejtur se Komisionet Disiplinore në disa raste nuk kanë arritur që ta vërtetojnë në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike dhe ta zbatojnë drejt ligjin material dhe po ashtu kanë zhvilluar procedurë, sikurse ka raste kur nuk janë përfillur dispozitat e aplikueshme ligjore lidhur me strukturën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ, shkelje këto që në shume raste kanë sjellë deri të paligjshmëria e vendimeve, në kuptim të nenit 52 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Rekomandime:

Duke marr parasysh konstatimet e mësipërme në këtë fushë, rekomandohen:

1. *Komisionet Disiplinore, me rastin e trajtimit të çështjeve disiplinore, ta kenë parasysh vlerësimin e kompetencës së iniciuesit të rastit, respektimin e afatit të vendosjes dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ, respektimin e procedurave ligjore lidhur me seancat disiplinore dhe njoftimin e të gjitha palëve të përfshira në procedurë, sikurse të njëjtat të jenë të njoftuara mbi të drejtat e parashikuara me ligj.*
2. *Institucionet e Administratës Publike të ofrojnë mundësi trajnimi për anëtarët e Komisionit Disiplinor për procedurat disiplinore dhe trajnime të tjera nga fushëveprimi i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative;*
3. *Instituti i Kosovës për Administratë Publike të shikojë mundësinë e ofrimit të trajnimeve për gjithë anëtarët e Komisioneve Disiplinore të institucioneve publike, lidhur me procedurat disiplinore dhe trajnime të tjera nga fushëveprimi i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*
4. *Institucionet e Administratës Publike të jenë të kujdesshme që anëtarët e Komisionit Disiplinor mos të jenë në periudhë provuese.*
5. *Institucionet e Administratës Publike të jenë të kujdesshme që nëpunësit e shërbimit publik nuk mund të jenë anëtar të komisioneve disiplinore për nëpunësit e shërbimit civil.*

6.6 VLERËSIMI I REZULTATEVE NË PUNË TË NËPUNËSVE CIVIL

Gjatë vitit 2024 Këshilli i ka pranuar 47 ankesa kundër vlerësimit të rezultateve të punës, nga rrjedh se numri i ankesave të pranuara nga nëpunësit civilë në këtë fushë përfaqëson 2.18% të numrit të përgjithshme të ankesave të pranuara gjatë periudhës raportuese, për dallim nga viti paraprak, ku numri i ankesave të pranuara në fushën përkatëse ishte 2.77%.

Në bazë të të dhënave të grumbulluara nga ushtrimi i funksioneve kushtetuese dhe ligjore, si shkelje më të shpeshta, ndërlidhur me këtë fushë, Këshilli ka evidentuar:

- *mungesën e planeve individuale të punës për nëpunësit civilë;*
- *mungesën e sugjerimeve brenda periudhës së vlerësimit lidhur me përmbushjen e objektivave të punës;*
- *mungesën e vlerësimit të rezultateve të punës dhe tejkalimi i afatit të vlerësimit;*

Sistemi i vlerësimit përfshirë këtu rregullat, kriteret, metodologjinë dhe procedurat për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë janë të përcaktuara me Rregulloren Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civilë dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 26/2024 Për Vlerësimin e

Rezultateve në Punë. Rrjedhimisht sipas këtij kuadri ligjor, vlerësimi i rezultateve në punë përmban matjen e realizimit të objektivave të përcaktuara dhe matjen e sjelljes profesionale të nëpunësit.

Nga të gjeturat e monitorimit si dhe ushtrimi i funksionit të shqyrtimit të ankesave, Këshilli ka konstatuar se vlerësimi i punës së nëpunësve civilë në disa institucione nuk është realizuar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, ngase në disa raste ka munguar përcaktimi i objektivave mbi bazën e të cilave do të duhej të kryhej vlerësimi i punës i nëpunësit civil, ashtu sikurse edhe vlerësimi i progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit.

Gjatë periudhës së vlerësimit vërehet fakti se nëpunësit civil nuk pranojnë sugjerime lidhur me përmbushjen e objektivave të punës apo kërkesa për rritjen e efikasitetit në punë. Po ashtu, ka raste kur vlerësimi i punës së nëpunësve civilë është bërë jashtë afateve të përcaktuara ligjore, e në disa raste vlerësimi i nëpunësve civilë nuk është bërë fare nga menaxheret drejtues.

Këshilli vlerëson se përcaktimi i objektivave dhe vlerësimi i rezultateve të punës për të gjitha kategoritë e nëpunësve civilë është detyrim ligjor i mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të nëpunësit civil dhe se mos përcaktimi i objektivave dhe, rrjedhimisht, mos vlerësimi i nëpunësit civil konsiderohet mos përmbushje e detyrave të punës, andaj paraqet edhe mohim të së drejtës së nëpunësit për zhvillim profesional.

Rekomandime:

Duke marr parasysh konstatimet e mësipërme në këtë fushë, rekomandohet që:

1. Menaxheret drejtues në shërbimin civil në bashkëpunim me Njësitë e Burimeve Njerëzore të përcaktojnë objektivat e punës për çdo fillim vit për vartësit e tyre dhe të mbikëqyrin progresin e arritur gjatë periudhës së vlerësimit.
2. Titullarët e institucioneve të kujdesen që të gjithë nëpunësit civilë në kuadër të institucionit përkatës janë vlerësuar nga menaxheret drejtues dhe atë brenda afateve të përcaktuara ligjore.
3. Te ketë mbikëqyrje për gjatë periudhës vlerësuese lidhur me përmbushjen e objektivave

6.7 TRANSFERIMI I NËPUNËSVE CIVIL

Në këtë fushë gjatë periudhës raportuese janë pranuar 87 ankesa apo 4.06% e numrit të përgjithshme të ankesave të pranuara, për dallim nga viti 2023 ku numri i ankesave të pranuara ishte 191 apo 12.06%. Kështu rrjedh se numri i ankesave në këtë fushë është zvogëluar për 8% në vitin 2024.

Këshilli, nga të dhënat e mbledhura gjatë ushtrimit të funksioneve kushtetuese dhe ligjore, si shkelje më të shpeshta ndërlidhur me këtë fushë ka evidentuar:

- transferimi pa një analizë paraprake lidhur me plotësimin e kushteve dhe kriterëve të pozitës së punës nga nëpunësi i transferuar;
- mos përcaktimi i kohëzgjatjes së transferimit;
- transferimi i përhershëm i nëpunësit civil pa pëlqimin e tij;
- transferimi me rastin e ristrukturimit;
- transferimi nga shërbimi publik në atë civil dhe anasjelltas

Gjatë ushtrimit të funksionit të shqyrtimit të ankesave si dhe funksionit të monitorimit janë vërejtur raste ku akti administrativ mbi transferimin e përkohshëm në interes të institucionit nuk ka përcaktuar edhe kohëzgjatjen e transferimit, siç përcaktohet me nenin 63 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, dhe si rrjedhojë një situatë e tillë ka krijuar pasiguri juridike të nëpunësit civilë të transferuar.

Ndër të tjera, në shumë raste, ka munguar një analizë paraprake nga njësia përgjegjëse për plotësimin e kualifikimit dhe kushteve të tjera të nëpunësit civil për pozitën në të cilën është transferuar.

Po ashtu tek rastet e transferimit të përhershëm sipas Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nuk janë respektuar procedurat e transferimit, gjegjësisht transferimi është bërë pa pëlqimin e nëpunësit civil.

Rekomandime:

Duke marr parasysh konstatimet e mësipërme në këtë fushë, rekomandohen:

1. *Vendimet për transferimin e përkohshëm dhe përhershëm të nëpunësve civilë, të miratohen drejtueses/it më të lartë administrativ, si dhe akti administrativ mbi transferimin të përmbajë në mënyrë të saktë kohëzgjatjen e transferimit.*
2. *Arsyetimi i vendimit të transferimit të përkohshëm dhe të përhershëm, duhet të përmbajë vlerësimin së nëpunësi plotëson kriteret e pozitës së punës ku transferohet. Ky vlerësim kryhet nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e institucionit ku nëpunësi është i punësuar.*
3. *Në secilin rast të transferimit të përhershëm për interes të institucionit, nëpunësit civil i cili transferohet duhet të jep pëlqimin e tij.*
4. *Në secilin rast Komisioni i Ristrukturimit duhet të ndërmarr të gjitha veprimet ligjore që propozimet për transferim në pozitë përkatëse të bëhen sipas legjislacionin përkatës.*
5. *Transferimi i zyrtarëve publik nuk mund të bëhet nga kategoria e nëpunësit të shërbimit civil në kategorinë e nëpunësit të shërbimit publik.*

6.8 DOSJET E PERSONELIT

Këshilli, duke u mbështetur në procesin e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës publike, ka konstatuar se administrimi dhe mirëmbajtja e dosjeve të personelit është në përmirësim të standardeve të përcaktuara me ligj. Vetëm të një numër i vogël i institucioneve të administratës publike është vërejtur se dosjet e personelit nuk i arkivon në vende të sigurta. Ndonëse vlerësimi është pozitiv në këtë fushë, Këshilli vlerëson se dosjet e personelit duhet të përditësohen në baza të rregullta.

Rekomandim:

Duke marr parasysh konstatimet e mësipërme në këtë fushë, rekomandohet:

1. *Njësiti përgjegjëse të institucioneve t'i përditësojnë në baza të rregullta dosjet e personelit në mënyrë që dosja të përmbajë fletën prezantuese dhe të gjitha të dhënat profesionale, personale, masat disiplinore, vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë të nëpunësit civil, si dhe të dhëna të tjera sipas shtojcës 1.1 të Rregullores (MPB) Nr. 05/2024 për Dosjen Individuale dhe Sistemin Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore*

6.9 PËRFAQËSIMI I PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, përkatësisht nenin 12 paragrafi 2 dhe 3 parashihet se: 2. Çdo punëdhënës është i obliguar të punësoj një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtorë. 3. Punëdhënësi i cili nuk i përmbush detyrimet nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, obligohet që për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara, të paguajë në buxhetin e Kosovës kontribute mujore në lartësi prej një për qind (1%) të shumës së pagës minimale.

Këshilli, në ushtrimin e funksionit të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë periudhës raportuese ka gjetur se pjesa më e madhe e institucioneve të administratës publike nuk ka arritur ta plotësojë kuotën e përfaqësimit të personave me aftësi të kufizuara, siç përcaktohet me dispozitat e nenit 12 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, dhe si rrjedhojë ka ofruar rekomandime të posaçme për zyrtarët përgjegjës të institucioneve të monitoruara.

Vlen të theksohet së Qeveria e Republikës së Kosovës, duke marr për bazë dispozitat ligjore përkatëse si dhe rekomandimet e Këshillit të vitit 2021, ka ndërmarrë veprime konkrete lidhur me këtë çështje, gjegjësisht ka nxjerr Vendimin me Nr. 221/2021 të datës 23.02.2022 me të cilin i ka obliguar institucionet e administratës shtetërore për plotësimin e kuotës së përcaktuar për punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Derisa Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e ka nxjerr Vendimin Nr. 19/2022 të datës 24.03.2022 për caktimin e kushteve për zbatimin e masës 1.6 - Mbështetja e personave me aftësi të kufizuara, në kuadër të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, ashtu që përmes kësaj mase, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e ka ofruar mundësinë që personat me aftësi të kufizuara të ndjekin trajnime për zhvillimin e mëtutjeshëm të shkathtësive të tyre, rrjedhimisht përmes trajnimit në punë (*on the job training*) mundësohet që të trajnuarit të kenë mundësi më të mira punësimi. Po ashtu ky institucion në shkurt të viti 2023 ka hapur llogari të veçantë bankare ku punëdhënësit nga sektori publik, privat dhe organizatat jo-qeveritare, të cilat nuk e përmbushin obligimin ligjor për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, obligohen që për nxitjen e punësimit të kësaj kategorie, të paguajnë kontribute mujore në lartësi prej një për qind (1%) të shumës së pagës minimale.

Ndërkaq sipas Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë përkatësisht neni 11 paragrafi 1, 2 dhe 3, përcaktojnë: 1. *Çdo institucion publik, është i obliguar të punësojë persona me aftësi të kufizuara, duke ju ofruar kushte të përshtatshme të punës, dhe atë një (1) person me aftësi të kufizuara për çdo pesëdhjetë (50) të punësuar në atë institucion.* 2. *Obligimi i përcaktuar në paragrafin 1. të këtij neni vlen edhe për institucionet publike me më pak se pesëdhjetë (50) të punësuar që duhet të punësojnë së paku një (1) person me aftësi të kufizuara.* 3. *Institucionet publike, me qëllim të plotësimit të kuotës sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të hapin konkurs të rekrutimit sipas dispozitave të këtij ligji vetëm për persona me aftësi të kufizuara.*

Rekomandim:

Duke marr parasysh konstatimet e mësipërme në këtë fushë, rekomandohet:

1. *Institucionet publike, janë të obliguara të përmbushin kriteret për këtë kategori, mirëpo nëse ato kriteret nuk kanë qenë të përmbushura atëherë sipas Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë respektivisht nenit 11 mund të hapin konkurs të rekrutimit sipas dispozitave të këtij ligji vetëm për persona me aftësi të kufizuara*
2. *Nëse personat me aftësi të kufizuara janë të nën përfaqësuar në kuadër të një institucioni atëherë mund të hapet procedura të pranimit të veçanta vetëm për këtë çështje, kështu që me qëllim të plotësimit të kuotës ligjore institucionit janë të obliguara të respektojnë dispozitat ligjore në fuqi, dhe për këtë janë paraparë edhe lehtësira ligjore.*

6.10 PËRFAQËSIMI ETNIK NË SHËRBIMIN CIVIL

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, me nenin 101.1 ka përcaktuar se: *“Përbërja e shërbimit civil do të pasqyrojë shumëllojshmërinë e popullit të Kosovës, duke marrë në konsideratë parimet e barazisë gjinore, të njohura ndërkombëtarisht”*.

Ndërsa me dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 10 të këtij ligji përcaktohet se në institucionet publike qendrore, minimum dhjetë për qind (10%) e vendeve të punës në të gjitha kategoritë e zyrtarëve publikë duhet të plotësohen nga pjesëtarët e komuniteteve, të cilat nuk janë shumicë në Kosovë dhe që përmbushin kriteret e pranimit, ndërsa në nivelin komunal, plotësimi i numrit të vendeve të punës për pjesëtarët e komuniteteve bëhet në pajtim me përqindjen e popullatës në atë komunë.

Siç mund të vërehet, me nenin 13 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, është përcaktuar se: *Institucionet publike me qëllim të plotësimit të kuotës si në paragrafin 1 të këtij neni, mund të hapin procedurë të rekrutimit vetëm për pjesëtarët e komuniteteve të nën përfaqësuar, rrjedhimisht është krijuar edhe baza ligjore që komunitetet e nën përfaqësuar të përfaqësohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.*

Rekomandim:

Duke marr parasysh konstatimet e mësipërme në këtë fushë, rekomandohet:

1. *Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Punëve të Brendshme, si ministri përgjegjëse për administratë publike, të hartojnë politika në nivel qendror dhe lokal që të sigurohet përfaqësimi etnik, sipas legjislacionit në fuqi për zyrtarët publikë. Në veçanti rekomandohet që politikat të garantojnë përfaqësim më të lartë të komuniteteve të nën përfaqësuar në shërbimin civil, gjegjësisht të komuniteteve jo shumicë, siç janë komuniteti rom, ashkali, goran, egjiptian, kroat, malazez, etj.*
2. *Nëse njëri nga komunitetet janë të nën përfaqësuar në kuadër të një institucioni, atëherë mund të hapet procedura të pranimit të veçanta vetëm për këtë çështje, kështu që me qëllim të plotësimit të kuotës ligjore dhe përfaqësimit institucionit janë të obliguara të respektojnë dispozitat ligjore në fuqi, dhe për këtë janë paraparë edhe lehtësira ligjore.*

PRIORITETET PËR VITIN 2025

Këshilli ka analizuar problematiken e evidentuar në këtë raport, e me pas ka përfshirë në planin e punës procese që ndërlidhen me realizimin e kompetencave të tij ligjore në fushën e mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil.

Përveç, shqyrtimit dhe vendosjes së ankesave të adresuara, Këshilli do të vijoj veprimtarinë e tij në drejtim të këshillimit dhe ndihmës së institucioneve për të zbatuar drejt ligjin, çka është një përvojë tashmë e krijuar, përmes realizimit të aktiviteteve të ndryshme dhe vizitave jo të rregullta monitoruese në institucionet e administratës publike.

Duke marr parasysh rëndësinë që ka procesi i ristrukturimit, si prioritet është vendosur mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit në këtë fushë dhe mbështetja e institucioneve të administratës publike përkatëse, për të siguruar respektimin e standardëve me të mira gjatë sistemit të nëpunësve civilë pas riorganizimit.

Rritja e performancës së institucionit të Këshillit do të jetë po ashtu në fokus gjatë këtij viti, pasi kjo ndikon në mënyrë direkte si në pavarësinë e institucionit, ashtu edhe në realizimin e të gjitha punëve që renditen me sipër. Ky aspekt sigurohet me ngritjen e kapaciteteve profesionale të burimeve njerëzore, në veçanti nëpërmjet trajnimeve specifike, për rritje të cilësisë së punës në ushtrimin e funksioneve të Këshillit.

Këshilli, do të vijoj të punoj për të ndihmuar në të gjitha aspektet që kanë lidhje me ecurinë e reformës në administratën publike, duke dhënë kontributin e tij në kuadër të zhvillimit të politikave dhe strategjive ku ai ndër vepron së bashku me akterët tjerë.

Sfidë e Këshillit mbetet që të sigurojë një proces të pavarur dhe efikas mbikëqyrje, me qëllim të parandalimit të shkeljeve të ligjit dhe kthimin e ligjshmërisë, në rastet kur ka ndodhur, nëpërmjet mekanizmave që i ka dhënë ligji.

Në përfundim të raportimit, Këshilli vlerëson se respektimi i legjislacionit të shërbimit civil dhe monitorimi i tij, janë aspekte thelbësore që sigurojnë suksesin e reformës në shërbimin civil, si pjesë e rëndësishme e reformës në administratën publike.

Duke shprehur se nëpërmjet këtij raporti, ju kemi paraqitur një përmbledhje të plotë e gjithëpërfshirëse të veprimtarisë së Këshillit për vitin 2024, Ju falënderojmë për mirëkuptimin.

Me respekt,

Arben MEHMETI

Kryetar i Këshillit të Pavarur
Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

7 RAPORTI FINANCIAR



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Emri i organizatës

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË
KOSOVËS**

Raporti Vjetor Financiar

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023

Neni 12

DEKLARATË E PASQYRAVE FINANCIARE

Për: **Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere**

Nga: **BUJAR SADIKU, Zyrtar Kryesor Administrativ (ZKA)**

ISLAM CAKAJ, Zyrtar Kryesor Financiar (ZKF)

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të cilat janë të bashkangjitura, përfshirë shënimet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007 dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Kjo deklaratë jepet në lidhje me prezantimin e Pasqyrave Financiare të organizatës buxhetore për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024 dhe është pjese përbërëse e pasqyrave financiare.

Ne besojmë dhe konfirmojmë, që:

- Nuk ka pasur parregullsi lidhur me udhëheqësin apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare.
- Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me burimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhura me Buxhetin e konsoliduar të Kosovës janë të plota dhe të sakta.
- Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave janë të sakta.
- Nuk ka tjera llogari bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës përveç llogarive bankare të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si në datën 31 dhjetor 2024.
- Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të autoriteteve rregullatorë të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare.
- Nuk ka ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare
- Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente, dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur në mënyrë të duhur.
- Të gjitha huat e pranuar janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur, sipas legjislacionit në fuqi
- Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës i cili do të kërkonte korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare që janë të bashkangjitura paraqesin një prezantim të vërtetë dhe të paanshëm të financave dhe transaksioneve financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024 të institucionit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Data: __/ __03__/ __2025__

(Nënshkrimi i ZKA)

Datë: __/ __03__/ __2025__

(Nënshkrimi i ZKF)



Neni 13
Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave të parave të KPMSHCK
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor

		2024	2023	2022
		Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit
		BKK '000	BKK '000	BKK '000
	Shënim			
BURIMET E FONDEVE -PRANIMET				
Granti qeveritar		395.00	359.00	326.00
Të hyrat vetanake				
Të hyrat e dedikuara				
Të hyrat nga AKP				
Grantet e përcaktuara të donat				
Klauzola e investimeve				
Fondi zhvillimor në mirëbesim				
Pranimet tjera				
Gjithsej		395.00	359.00	326.00
SHFRYTEZIMI I FONDEVE - PAGESAT				
Operacionet				
Paga dhe rroga	2	295.00	265.00	233.00
Mallra dhe shërbime	3	98.00	92.00	91.00
Shpenzime komunale	4	2.00	2.00	2.00
		395.00	359.00	326.00
Transferet				
Transfere dhe subvencio	5			
Shpenzime kapitale				
Prona, ndërtesa dhe pajis	6			
Pagesa tjera	7			
Gjithsej		395.00	359.00	326.00

Shënim: Nga pasqyra e pranimet dhe pagesave në para të gatshme për vitin 2024, janë pranua mjete në shumë prej:395 mijë €, sipas kategorive ekonomike: paga dhe mëditje 295 mijë €, mallra dhe shërbime 98 mijë € si dhe shërbime komunale 2 mijë €. Në pasqyrë shihet qartë edhe trendi i pranimeve dhe shpenzimeve nëpër vite:2022,2023,2024



Neni 14
Raporti i ekzekutimit të buxhetit
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

		2024				2023	2022
		Realizimi	Buxhet i final	Buxheti fillestar	Varianca	Realizimi	Realizimi
		A	B	C	D=B-A	E	F
		€ '000	€ '000	€ '000	%	€ '000	€ '000
HYRJA E PARASË SË GATSHME							
Të hyrat tatimore	8						
Të hyrat jo tatimore	9						
Të hyrat e dedikuara	10						
Grantet e përcaktuara të	11						
Tjera	12						
Gjithsej Pranimet		-	-	-		-	-
DALJA E PARASË SË GATSHME							
Paga dhe rroga	2	295	295	318	100.00%	265	233
Mallra dhe shërbime	3	98	100	100	98.00%	92	91
Shpenzime komunale	4	2	4	4	50.00%	2	2
Transfere dhe subvencio	5	-	-	-	0.00%	-	-
Shpenzime kapitale	6	-	-	-	0.00%	-	-
Tjerat	7	-	-	-	0.00%	-	-
Gjithsej pagesat		395	399	422	99.00%	359	326

Shënim: Në kolonën D kemi variancën (ndryshimin), në mes Buxheti final në SIMFK (kolona B) dhe realizimit (kolona A) për vitin 2024 ku ka një ndryshim (variancë), prej 4 mijë € që janë mjete të kursyera sipas kategorive ekonomike: mallra dhe shërbime, në shumën prej 2 mijë €, mjetet të cilat kanë qenë të zotuar por për shkak të vonesës së faturave, kostimit dhe racionalizimit të shpenzimeve, nuk janë shpenzuar, si dhe në kategorinë ekonomike shërbime komunale janë kursyer 2 mijë €, si rrjedhojë e kursimit të mjeteve në telefoninë fikse nga stafi i Këshillit.

Neni 15

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

Shënimi 1

1. Politikat kontabël

Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”, i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr.04/L-116, Ligjin nr.04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007.

1.1 Informata për organizatën buxhetore (aktivitetet, legjislacioni, etj)

Entitet i sektorit publik Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka përgatitur Pasqyrat Financiare në harmoni me kërkesat e Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007.

Sipas LMFPF të gjitha transaksionet me fonde brenda Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës behën përmes Llogarisë së Vetme të Thesarit.

Këshilli është institucion i pavarur i themeluar me aktin më të lartë juridik të Republikës së Kosovës, përkatësisht me nenin 101.2 të Kushtetutës, ku përcaktohet se: *"Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës"*.

Këshilli ushtron funksionet dhe përgjegjësitë themelore në pajtim me:

- Kushtetutën e Republikës së Kosovës;
- Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe aktet nënligjore që derivojnë nga ky ligj;
- Aktgjykimin në rastin KO171/18 të datës 20 maj 2019 të Gjykatës Kushtetuese.

Me Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përcaktohen funksionet, kompetencat, organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Bazuar në dispozitat e nenit 30 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, aktet nënligjore të miratuara, janë:

- Rregullorja Nr.01/2018 për punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
- Rregullorja Nr.01/2021 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr.01/2018 për punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;

- Rregullorja Nr.02/2018 për procedurën e shqyrtimit dhe vendosjes së ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
- Rregullorja Nr.04/2018 për procedurën e monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil;
- Rregullorja Nr.02/2021 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr.04/2018 për procedurën e monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil;
- Rregullorja Nr.01/2023 për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
- Kodi i Etikës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;

Misioni – të mbikëqyr respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.

Vizioni - të garantojë mbizotërimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil përgjatë procedurës së pranimit, emërimit, lëvizjes brenda kategorisë dhe ngritjes në detyrë, transferimit, pezullimit, vlerësimit, procedurës disiplinore, zhvillimit profesional, të drejtat dhe detyrimet e nëpunësit civil, dhe përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, me qëllim që ky proces të jetë i ndershëm, objektiv, i paanshëm dhe transparent për një administratë publike (shërbimi civil) të qëndrueshme, profesionale, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike.

Me qëllim të përmbushjes së misionit synon të realizojë këto objektiva:

- Shqyrtimi i të gjitha ankesave të nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbim civil;
- Mbikëqyrja dhe vlerësimi i respektimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil;
- Funksionalizimi i strukturës organizative;
- Përditësimi i akteve nënligjore të Këshillit;
- Avancimi i bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare;
- Forcimi i kapaciteteve profesionale të Këshillit;
- Ngritja e mëtejme e transparencës së Këshillit;

1.2 Pagesat nga palët e treta

Në zbatim të SNKSP 2017 pagesat nga palët e treta shpalosen në shënimin 13.

1.3 Shumat raportuese

Shumat raportuese nga neni:

13 deri te neni 15 janë në `000 (mijë) Euro (€),

16 deri te neni 24 shumat janë shuma e plotë Euro (€).

1.4 Valuta raportuese

Shumat janë raportuar në valutën Euro (€),

1.5 Data e autorizimit

Autorizohen me datën e nënshkrimit të deklaratës për Pasqyrat Financiare nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Neni 14.6

Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit

Kategoria e ndarjes	Buxheti Fillestar (Ligji- 08/L-260) € '000	<u>Ndryshimet e autorizuar nga LMFP</u>				Grantet e percaktuara te donetoreve € '000	Burime tjera te financimit € '000	Buxheti përfundimtar SIMFK € '000
		Vendim i- 03/239 € '000	Ndryshi mi II € '000	Ndrysh imi III € '000	Ndrysh imi IV € '000			
Hyrjet								
Të hyrat tatimore								-
Të hyrat jo tatimore								-
Të hyrat e dedikuara								-
Grantet e percaktuara të donatorëve								-
Huamarrjet								-
Tjera								-
Gjithsej	-	-	-	-		-	-	-
Daljet								
Paga dhe rroga	318	(23)	0	0	0	0	0	295
Mallra dhe shërbime	100	0	0	0	0	0	0	100
Shpenzime komunale	4	0	0	0	0	0	0	4
Transfere dhe subvencione	-							
Shpenzime kapitale								
Kthimi i huamarrjeve								
Tjerat								
Gjithsej	422	(23)	0	0		0	0	399

Shpalos në detaje shënimet në tabelë: Buxheti i Këshillit ka pasur një ndryshim prej 23 mijë Euro në kategorinë paga dhe mëditje sipas vendimit Nr.03/239 të datës 27.12.2024 për ri destinim në organizata tjera buxhetore.



Shënimi 2 deri 12 Prezantim i ndryshimeve materiale

Për dallim prej shënimeve 2 deri 12, këto shënime përdoren për të sqaruar dallimin **material** në kolonën **D (neni 14)**, domethënë dallimin material të realizimit të buxhetit. SNKSP në bazë të parasë se gatshme kërkon të sqarohen dallimet materiale. Varësisht nga madhësia e dallimit, nuk kanë nevojë të ofrohen shpjegime për të gjitha kategoritë, andaj mund të kërkojen ndryshime në sistemin e numërimit të shënimeve. Kur të sqarohen dallimet e ndonjë kategorie të ndarjes, duhet të jepet përmbledhja e natyrës së ndryshimit.

Shënimi 2 Paga dhe rroga

Përshkrimi	2024									Krahasim %	2023	2022
	Gjithsej Pagesat	GQ	THV	THD	TH-AKP	GPD	K I	FZHM	Buxheti Final		€ '000	€ '000
	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000		€ '000	€ '000
Pagat neto përmes listës së pagave	247	247							270	1	219	189
Pagesa per sindikatë	-	-							-	0		
Pagesa neto për punë jashtë orarit	1	1							1	0	3	8
Puntëtorët me kontratë (jo në listen e pagave)	-	-							-	0	-	-
Tatimi ndaluar në të ardhura personale	19	19							19	0	17	14
Kontributi pensional-punetori	14	14							14	0	13	11
Kontributi pensional-punëdhënësi	14	14							14	0	13	11
Paga dhe rroga	295	295							318	1%	265	233

Shpalos në detaje shënimet e pasqyruara në tabelë: Nga tabela e më sipër, shfrytëzimi i buxhetit në kategorinë: Paga dhe shtesa për vitin 2024, është bërë në tërësi sipas ligjit të buxhetit. Kursimet 23 mijë Euro në kategorinë paga dhe mëditje kanë të bëjnë me rekrutimin e dy anëtarëve nga minoritetet nga ana e kuvendit të Kosovës, mjete të cilat sipas vendimit Nr.03/239 të datës 27.12.2024 janë ri destinuar për organizata tjera buxhetore.



Shënimi 3 Mallra dhe shërbime

Përshkrimi	2024							2023		2022
	Gjithsej Pagesat € '000	GQ € '000	THD € '000	AK € '000	GPD € '000	FZHM € '000	Buxheti		€ '000	€ '000
							Final Kraha	sim		
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit	-									
Meditjet për udhëtime zyrtre brenda vendit	-									6
Akomodimi udhëtime zyrtre brenda vendit	1.00	1					1	0	1	0
Shpenzime tjera për udhëtime zyrtre brenda vendit	-	0					-	0	3	0
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	-	0					-	0	1	0
Meditjet për udhëtime zyrtre jashtë vendit	13.00	13					13	0	0	0
Akomodimi udhëtime zyrtre jashtë vendit	15.00	15					15	0	10	7
Shpenzime tjera udhëtime zyrtre jashtë vendit	4.00	4					4	0	9	5
Shpenzimet per internet	-	0					-	0	3	6
Shpenzimet e telefonisë mobile	9.00	9					9	0	0	0
Shpenzimet postare	9.00	9					9	0	9	9
Shpenzimet për përdorimin e kabllit optik	-	0					-	0	10	8
Shërbimet e arsimit trajnimit	-	0					-	0	0	0
Shërbimet e përfaqësimit avokatë dhe eksperte	-	0					-	0	0	0
Shpenzime të rexhistritimit automjeteve	1.00	1					1	0	4	8
Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillimore	-	0					-	0	0	0
Mirëmbajtje automjeteve	3.00	3					3	0	6	6
Shërbime kontraktuese tjera	1.00	1					1	0	1	1
Furnizim për zyre	6.00	6					6	0	2	2
Shpenzimet për derivate	7.00	7					7	0	0	0
Paisje tjera	-	0					-	0	2	2
Mobilje (me pak se 1000 euro)	-	0					-	0	13	14
Qiraja për paisje	3.00	3					3	0	-	1
Kompjuterë me pak se 1000 euro	6.00	6					6	0	-	-
Qiraja për makina	13.00	13					14	1	4	6
Shpenzime të reprezentimit	7.00	7					8	1	6	2
Shto kode sipas nevojës									8	8
Mallra dhe shërbime	98	98	-	-	-	-	100	2	92	91

Shpalos në detaje shënimet në tabelë: Nga tabela e mësipërme shihet se për periudhën raportuese 2023, kursimi në shumën prej 6 mijë €, janë mjetet të cilat kanë qenë të zotuar, por për shkak të vonësës së faturave, kostimit dhe racionalizimit të shpenzimeve, nuk janë shpenzuar.



Shënimi 4 Shpenzime komunale

Përshkrimi	2024								Buxheti Final € '000	Kra hasi € '000	2023 € '000	2022 € '000
	Gjithsej											
	Page € '000	GQ € '000	THV € '000	THD € '000	AKP € '000	GPD € '000	K I € '000	FZHM € '000				
Rryma	-	0							-	0	0	
Uji	-	0							-	0	0	
Mbeturinat	-	0							-	0	0	
Ngrohja Qendrore	-	0							-	0	0	
Shpenzimet telefonike	2	2							4	2	2	
Pagesa-vendimet gjqyqësore	-	0							-	0	0	
Shpenzime komunale	2	2	-	-	-	-	-	-	4	50% 2	2	

Shpalos në detaje shënimet në tabelë: Duke iu referuar të dhënave si në tabelën më sipër, mund të kolaudojmë se shërbimet komunale gjegjësisht niveli i shpenzimeve në kuadër të telefonisë fikse ka mbetur i njëjtë përgjatë tri viteve. Janë mjete të kursyera nga personeli i Këshillit të cilat janë të nevojshme por shpenzimi është 50% më i ulët.

**Shënimi 5 Subvencione dhe transfere**

Shpalos në detaje shënimet në tabelë: *Këshilli nuk ka buxhet në kategorinë Subvencione dhe Transfere*

Shënimi 6 Shpenzime kapitale

Shpalos në detaje shënimet në tabelë: *Këshilli nuk ka buxhet në kategorinë Shpenzime Kapitale.*

Shënimi 7 Tjera

Shpalos në detaje shënimet në tabelë: *Këshilli nuk ka pagesa tjera.*

Shënimi 8 Te hyrat tatimore

Shpalos në detaje shënimet në tabelë: *Këshilli nuk ka të hyra tatimore.*

Shënimi 9 Të hyrat jo tatimore

Shpalos në detaje shënimet në tabelë: *Këshilli nuk ka të hyra jo tatimore.*

Shënimi 10 Të hyrat e dedikuara

Shpalos në detaje shënimet e pasqyruara në tabelë: *Këshilli nuk ka të hyra të dedikuara.*

Shënimi 11 Grantet e përcaktuara të donatorëve

Shpalos në detaje shënimet e pasqyruara në tabelë: *Këshilli nuk ka grante të përcaktuara të donatorëve.*

Shënimi 12 Tjera

Shpalos në detaje shënimet në tabelë: *Këshilli nuk ka pranime tjera.*

Shënimi 13 Pagesa nga palët e treta

Shpalos tabelën në detaje si në tabelën në vijim aneks 1: *Këshilli nuk ka pagesa nga palët e treta.*

Neni 16 Raport për të arkëtueshmet

Të arkëtueshmet (zbatohet për organizatat që mbledhin të hyra)

Shpalos ne PF tabelën në detaje dhe sipas formatit si Aneks 1: *Këshilli nuk mbledh të hyra.*



Neni 17 Raport për detyrimet (faturat) e papaguara

		2024		2023		2022	
Ekonomik e	Kategoria ekonomike	< 30 ditë	> 30 ditë	< 30 ditë	> 30 ditë	< 30 ditë	> 30 ditë
11	Paga dhe rroga	0		0		0	
13	Mallra dhe shërbime	4518.41		4700.76		4199.83	
14	Shpenzime komunale	144.5		112.31		125.73	
20	Transfere dhe subvenci	0		0		0	
30	Shpenzime kapitale	0		0		0	
Gjithsej		4663.55	0	4813.07		4325.56	0

Shpalos ne PF tabelën në detaje dhe sipas formatit si Aneks 2

Data e pranimit te fatures	Numri i faturës	Kodi ekono mik	Afati i pagesës	Furnitori	Përshkrimi	Arsyeja e mospagesës	2024
15.01.2025	508/24	13	02.02.2025	AUTOLARJ AJANI&ADAMI		Fatura ka ardhur me vonesë	22.5
31.12.2024	7056/24	13	24.01.2025	PETROL COMPANY SH.P.K		Fatura ka ardhur me vonesë	881.44
31.12.2024	2405	13	06.02.2025	VALA		Fatura ka ardhur me vonesë	1530.01
31.12.2024	46015	13	14.02.2025	D.P.H LUZERN		Pjesërishtë e paguar	749.9
31.12.2024	45627	13	14.02.2025	RIKON SHPK		Pjesërishtë e paguar	1016.7
31.12.	2408	15	05.02.2025	Telekomi I KOS.	45657	Fatura ka ardhur me v	144.59
31.12.2024	7903/24	13	19.02.2024	PETROL COMPANY SH.	45657	Fatura ka ardhur me v	318.41
Gjithësejtë							4663.55

Neni 18 Detyrimet kontingjente

Shpalos në detaje shënimet në tabelë: Këshilli nuk ka detyrime kontigjente.



Neni 19 Raport për pasurinë jo financiare

Neni 19.3.1 Pasuritë kapitale (me vlerë mbi 1000 Euro)

Klasifikimi i pasurive	2024	2023	2022
Ndërtesat	0	0	0
Toka	0	0	0
Pajisjet	0	449.94	1992.6
Infrastruktura	0	0	0
Makineria	0	0	0
Automjetet	0	0	0
Tjera	0	0	0
Gjithsej	0	449.94	1992.6

Neni 19.3.2 Pasuritë jo kapitale (me vlerë nën 1,000 Euro)

Klasifikimi i pasurive	2024	2023	2022
Pajisjet dhe mobiljet	11618.55	24221.23	28385.14
Gjithsej	11,618.50	24,221.23	28,385.14

Shpalos ne PF tabelën në detaje në vijim si Aneks 3:

Neni 19.3.3 Stoqet

Klasifikimi i pasurive	2024	2023	2022
Stoqet	1,677.15	1,114.68	999.45
Gjithsej	1,677.15	1,114.68	999.45

Neni 20 Raport për avancet e pa arsyetuara

Shpalos me poshtë në detaje shënimet nga tabela: *Këshilli nuk ka avanse të pa arsyetuara dhe të pa mbyllura.*

Neni 21 Raport për të hyrat vetanake të pashpenzuara

Neni 22 Raport për bilancet e pashpenzuara të Fondit Zhvillimor në Mirëbesim

Neni 23 Raport për të hyrat e dedikuara

Neni 24 Raport për fondet e donatorëve të pashpenzuara

Shënim: Këshilli nuk ka të hyra vetanake të pashpenzuara, nuk ka bilance të pashpenzuara të Fondit Zhvillimor në Mirëbesim, nuk ka të hyra të dedikuara, nuk ka fonde nga donatorët.

Neni 25 Raport për numrin e punëtorëve sipas listës së pagave

Departamenti	Nr i punëtorëve në Ligjin e buxhetit	Nr aktual i punëtorëve në fund të 2024		Nr aktual i punëtorëve në fund të 2023		Nr aktual i punëtorëve në fund të 2022	
		Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Funksionar Publik	7	4	0	5	0	5	0
Shërbyes civil	21	21	0	20	0	20	0
Nëpunës Teknik	2	2	0	1	0	1	0
Gjithsej	30	27	0	26	0	26	0

Neni 26 Raport për numrin e të punësuarve jashtë listës së pagave

Shënim: Këshilli nuk ka asnjë të punësuar jashtë listës së pagave.

Neni 27 Raport për numrin e të punësuarve me kontrate për shërbime te veçanta

Shënim: Këshilli nuk ka asnjë të punësuar me kontratë të shërbimeve të veçanta.

Neni 28 Raport për gjendjen/zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)

Shënim: Këshilli nga vitet paraprak 2022, 2023 nuk ka pasur asnjë rekomandim.

8 RAPORTIMI RRETH ADRESIMIT TË REKOMANDIMEVE TË ZYRES KOMBËTARE TË AUDITIMIT

Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Këshillit, i dorëzuar me datë 25.05.2024 me numër protokolli: 948 nga Zyra Kombëtare e Auditimit përfshin opinionin e auditimit, informacionin e përmbledhur mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit, nuk ka dhënë asnjë rekomandim për auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2023.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka potencuar:

1. **Opinionin e auditimit** – ku ka pasqyruar auditimin e kryer dhe ka vërtetuar se pasqyrat financiare deri me 31.12.2023 prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme dhe ka shprehë bazën për **opinion të pamodifikuar**.
2. **Gjatja dhe rekomandimi** – Zyra Kombëtare e Auditimit nuk ka dhënë asnjë rekomandim.
3. **Progresi për zbatimin e rekomandimit** - Raporti për gjendjen/zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA), tregon se Këshilli nuk **ka pasur** rekomandim nga viti paraprak 2022.